

VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.9(446)

SHTATOR 2025

ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI ; website: www.VETERANIOBVL.ORG

NDERI I KOMBIT

**PARLLAKU, GJENERALI QË FITOI
LAVDINË DHE PAVDEKËSINË**



Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

FAQE 4

SHEFI I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM

**OBVLP URON GJENERALLEJTËNANT
ARBEN KINGJIN PËR MANDATIN E DYTË**



FAQE 9

DOSSIER

**84 VJET MË
PARË -
QËNDRESA
HEROIKE NË
KODËR TË
KACËS**



Nga Dine KACA

FAQE 14 - 15

Koha kërkon që kësaj ngjarje të madhe historike dhe aktorëve që e iniciuan, t'u bëhet vlerësimi i duhur

KONFERENCA E PEZËS, NGJARJA MË MADHORE E LANÇ-it

OPINION

**VETËM FUQIA E
USA – TRUMP ND-
ALON LUFTËN E III
BOTËRORE**

Në opinionin e para disa javëve (publikuar nga mediat shqiptare), trajtova disa pikëpyetje me peshë gjeopolitike si: A ndodhemi në prag të Luftës së Tretë Botërore? Kush mund të jenë pasojat fatale dhe ç'farë peshe mbart Inteligjenca Artificiale, robotët, dronët dhe fuqia kibernetike? A do të ketë fitues, apo vetëm të humbur në një luftë e tillë etj.!

FAQE 8

Gjeneral © PIRO AHMETAJ

REAGIMI

**KRYESIA E OBVLP
DËNON THIRRJET
ANTISHQIPTARE NË
KUMANOVË**

Shqipëria dhe shqiptarët mbeten të palëkundur në promovimin e një bashkëjetese model dhe larg ndasive të dala mode e boje

FAQE 2

PORTRET

**Doktor Ismail Feta,
kirurgu i 30 000
operacioneve**

Prof. dr. Hajri Shehu

FAQE 5



• **PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ** : Konferenca e Pezës sjell edhe sot një përvojë të çmuar dhe të vlefshme për shoqërinë shqiptare. Mesazhi dhe mësimi i madh i Konferencës së Pezës që është dialogu, mirëkuptimi dhe bashkëpunimi mes shqiptarëve e forcave politike qëndron gjithmonë actual

FAQE 3

REFLEKSIONE

MODELI I FAMILJES SË DËSHMORIT



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

FAQE 6

81 VJETORI

**RRUGA E LAVDISHME
E BRIGADAVE
TË 20-të, 22-të DHE 23
SULMUESE PARTIZANE**

FAQE 12 - 13

STUDIMI

**SKËNDERBEU,
STRATEG E
DIPLOMAT I MADH**


Prof. ALI HOXHA

FAQE 10 - 11

LIBRI

Prof. XHEMAL MEÇI BOTON LIBRIN E RI

**PUKA PËR LIRI E
PAVARËSI DHE
DËSHMORËT E SAJ**



FAQE 7

REAGIMI

Shqipëria dhe shqiptarët mbeten të palëkundur në promovimin e një bashkëjetese model dhe larg ndasive të dala mode e boje

KRYESIA E OBVLP DËNON THIRRJET ANTISHQIPTARE NË KUMANOVË

Kryesia e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar dhe pasardhësve (OBVLP) dënon ashpër thirrjet e egra antishqiptare që u hodhën në Kumanovë, gjatë ndeshjes së Basketbollit ndërmjet RMV-së dhe Rumanisë më 2 gusht 2025.

Ajo vlerëson reagimin e shtetit shqiptar nëpërmjet kryetres së Kuvendit Elisa Spiropali, sipas së cilës: Ngjarja e 2 gushtit 2025 në Kumanovë, ku një ndeshje basketbolli u njollos nga thirrje ekstremisht fyese dhe përjashtuese ndaj shqiptarëve, është e papranueshme dhe një kujtesë se rruga drejt një shoqërie të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të respektit të ndërsjellë kërkon angazhim të pandërprerë.

Kryesia e OBVLP i bashkohet këtij reagimi për faktin se “Gjuha e urrejtjes që nxit dhunën, konfliktin etnik dhe racizmin, nuk ka vend në asnjë hapësirë publike, e aq më pak në sport, që në thelb të tij mbart frymën e bashkimit, të bashkëpunimit, të lojës së ndershme dhe të respektit ndaj tjetrit”.

Po ashtu Kryesia e OBVLP vlerëson reagimin e institucioneve të RMV, duke kërkuar njëkohësisht reagim edhe më fortë publik të zyrtarëve më të lartë të vendit mik.

Bashkëjetesa ndëretnike në Maqedoninë e Veriut është një vlerë e përbashkët në rrugën europiane, që duhet ruajtur dhe kultivuar me përgjegjësi nga të gjithë faktorët në rajon, përmes veprimt, qëndrimeve dhe shembullit.

Sjellja korrekte në fusha, në tribuna dhe në institucione flet shumë për

• Ngjarja e 2 gushtit 2025 në Kumanovë, ku një ndeshje basketbolli u njollos nga thirrje ekstremisht fyese dhe përjashtuese ndaj shqiptarëve, është e papranueshme dhe një kujtesë se rruga drejt një shoqërie të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të respektit të ndërsjellë kërkon angazhim të pandërprerë



vizionin tonë për të ardhmen.

Shqipëria dhe shqiptarët mbeten të palëkundur në promovimin e një bashkëjetese model dhe larg ndasive të dala mode e boje.

NGJARJA....

Sipas mediave shqiptare në RMV, të cilat cila kanë publikuar pamjet, në thirrjet e tifozëve dëgjohet të thuhet: “Le ta kuptojnë shqiptarët e mallkuar, emri maqedonas nuk do të zhdukët,

Maqedoni e pastër, e pastër, e pastër”.

Koret vazhduan pavarësisht pranisë në sallë të kryeministrit Hristijan Mickoski, kryetarit të Kumanovës Maksim Dimitrievski, ministrit të punëve të jashtme Panço Toshkovski, zëvendëskryeministrit Ivan Stoilkoviç dhe zyrtarëve të tjerë të lartë shtetërorë.

Ky nuk ishte momenti i vetëm provokues gjatë ndeshjes.

Përgjatë zhvillimit të saj, u dëgjuan

edhe thirrje të tjera skandaloze dhe nxitëse të urrejtjes etnike, si parulla famëkeqe “Shqiptari i mirë është shqiptari i vdekur”, si dhe “Dhoma të gazit për shqiptarët”, që përkujtojnë retorikën më të errët të historisë evropiane.

Pas përfundimit të ndeshjes, nuk pati asnjë reagim zyrtar, distancim publik apo kërkim falje nga organizatorët apo përfaqësuesit institucionalë për incidentin.

Ndaj këtyre thirrjeve, ka reaguar ashpër Zëvendëskryeministri i parë i Maqedonisë së Veriut, Izet Mexhiti.

“Dënoj ashpër thirrjet raciste dhe anti-shqiptare të dëguara gjatë ndeshjes së basketbollit. Fjalët fyese dhe këngët që nxisin urrejtje, nuk kanë vend në shtetin dhe shoqërinë tonë”, shkroi Mexhiti në reagimin e tij publik.

Ai shtoi se këto veprime përbëjnë një sulm të drejtpërdrejtë ndaj bashkëjetesës dhe barazisë që, sipas tij, e bëjnë Maqedoninë e Veriut një shtet unik.

Edhe zëvendëskryeministri Arben Fetai, ka reaguar ashpër pas episodeve të ksenofobisë dhe gjuhës së urrejtjes drejtuar shqiptarëve gjatë ndeshjes kualifikuese për Kupën e Botës në Basketboll 2027, e zhvilluar mbrëmjen e djeshme ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Rumanisë.

Përmes një deklarate të publikuar në rrjetet sociale, Fetai e cilësoi këtë sjellje si një “tradhti të turpshme ndaj vlerave të respektit dhe fair play-it që sporti duhet të përfaqësojë”.

“Ksenofobia dhe gjuha e urrejtjes, pavarësisht se nga cila palë vjen, nuk kanë vend në stadiumet tona, në shoqërinë tonë, as në të ardhmen tonë të përbashkët”, tha ai.

Fetai u bëri thirrje tifozëve, autoriteteve sportive dhe institucioneve përgjegjëse që të marrin masa të vendosura për të ndaluar këtë fenomen të rrezikshëm, duke theksuar se heshtja ose mosveprimi vetëm sa e thellojnë urrejtjen.

“Si shtet, ne duhet të promovojmë gjithëpërfshirjen dhe respektin në të gjitha aspektet e jetës, përfshirë sportin. Le të punojmë së bashku për të ndërtuar një Maqedoni të Veriut ku përçarja nuk është opsion dhe ku diversiteti është forca jonë, ndërsa uniteti krenaria jonë”, përfundoi ai.

Edhe Bashkimi Demokratik për Integritet ka shprehur indinjatën dhe revoltën më të thellë për ngjarjen skandaloze që ndodhi mbrëmë në Kumanovë.

Reagimi i politikanëve shqiptarë në Maqedoninë e Veriut për skandalin në Kumanovë

Turp për sportin, goditje ndaj qytetarisë

Zëvendëskryeministri shqiptar i Maqedonisë së Veriut, Izet Mexhiti, dënoi gjuhën fyese ndaj shqiptarëve në ndeshjen e basketbollit në Kumanovë.

“Fjalët fyese dhe këngët që nxisin urrejtje, nuk kanë vend në shtetin dhe shoqërinë tonë”, tha ai duke shtuar se këto veprime përbëjnë një sulm të drejtpërdrejtë ndaj bashkëjetesës dhe barazisë në Maqedoninë e Veriut.

Kryetari i Tetovës, Bilall Kasami, po ashtu dënoi gjuhën e urrejtjes.

“Ajo që ndodhi në Kumanovë nuk është vetëm një moment turpi për sportin, por një goditje me grusht ndaj idesë më themelore të qytetarisë: që ne jemi të ndryshëm, por të barabartë. Fyerjet raciste nuk janë “shprehje spontane të pakënaqësisë”, por tërbime primitive që kërkojnë vend në një kohë që nuk u përket”, tha ai.

VMRO-DPMNE-ja i cilësoi thirrjet si të përgatitura nga struktura kriminale që duan të mbulojnë veprimtarinë e tyre me urrejtje dhe përçarje.

“Dënojmë çdo sulm nationalist dhe



gjuhë të urrejtjes, pa marrë parasysh se nga vijnë. Kjo i shkon për shtat vetëm rrymave dhe partive politike që me vite mbjellin politika të urrejtjes ndaj njëri tjetrit”, shtoi Brane Petrushevski, deputet i VMRO-DPMNE-së.

Veprimet i dënoi edhe opozita.

“Më 2 gusht në Kumanovë, në një ndeshje basketbolli, në prezencë të Kryeministrit Mickovski, përfaqësues të VLEN-it, ministrit të punëve të Brendshme Toshkovski e të tjerë pushtetarë, neve, shqiptarëve na është sharë nëna, familja, origjina, fisi dhe fara në kor nga tifozë maqedonas”, tha

Arben Taravari, Kryetar i Aleancës për Shqiptarët.

BDI kërkon dorëheqjen e dy zëvendësministrave nga radhët e VLEN.

“BDI kërkon përgjegjësi politike për skandalin në Kumanovë: Të dorëhiqen Astrit Iseni dhe Safije Sadiki Shaini. Njëkohësisht, kërkojmë që të gjithë përfaqësuesit shqiptarë në Qeveri që janë në pozita kyçe ekzekutive, të distancohen publikisht nga ky akt i papranueshëm dhe ta ngrenë këtë çështje në mbledhjen e ardhshme të Qeverisë”.

PËRGATITI FAQEN: KIMETE RAMA

ANALIZA

Koha kërkon që kësaj ngjarje të madhe historike dhe aktorëve që e iniciuan, t’u bëhet vlerësimi i duhur

Konferenca e Pezës, ngjarja më madhore e LANÇ-it

• Konferenca e Pezës sjell edhe sot një përvojë të çmuar dhe të vlefshme për shoqërinë shqiptare. Mesazhi dhe mësimi i madh i Konferencës së Pezës që është dialogu, mirëkuptimi dhe bashkëpunimi mes shqiptarëve e forcave politike qëndron gjithmonë aktual



PROF. ASOC. DR.
BERNARD ZOTAJ

Konferenca e Pezës e mbajtur më 16 shtator 1942 është ngjarja më madhore e LANÇ-it, për të cilën është shkruar e do të shkruhet në shekuj. Vlera e kësaj konference qëndron në rëndësinë e vendimeve për fatet e kësaj lufte. Detyra jonë është që kjo të nderohet e të përkujtohet. Konferenca e Pezës sjell edhe sot një përvojë të çmuar dhe të vlefshme për shoqërinë shqiptare. Mesazhi dhe mësimi i madh i Konferencës së Pezës qëndron gjithmonë aktual që është dialogu, mirëkuptimi dhe bashkëpunimi mes shqiptarëve e forcave politike. Këto pavarësisht nga bindjet, alternativat e orientimet e ideologjike, gjithmonë i bashkon një çështje e madhe e përbashkët, çështja kombëtare, përparimi dhe bashkimi i kombit. Konferenca e Pezës gjithmonë përbën një objekt me rëndësi studimi e hulumtimi për historinë. Në vitet e demokracisë ku mendimi i lirë pluralist, ka përparësi, opinionin publik ka lexuar shkrime me vlerësime të ndryshme për Konferencën e Pezës dhe protagonistët e saj. Koha kërkon që kësaj ngjarje të madhe historike dhe aktorëve që e iniciuan, t’u bëhet vlerësimi i duhur. Rëndësia e Konferencës së Pezës qëndron në rolin që luajti në ecurinë e procesit të luftës. Vendimi për thirrjen e Konferencës, kur situata ishte e rëndë, e vështirë, e mbushur me rreziqe të mëdha, për ekzistencën si popull e si komb.

Shoqëria shqiptare gjendej në udhëkryq, ndaj kërkohej reflektim i thellë, shpejt, mobilizim e angazhim i përgjithshëm, i forcave patriotike në vend, për të marrë në dorë fatet e atdheut që vuante nga pushtimi fashist. Shpëtimi dhe çlirimi i ven-

dit do të vinte nga populli, që priste të organizohej e të mobilizohej për luftë. Konceptimi i situatës, ndjenja e përgjegjësisë, preokupimi për zgjidhjen e problemeve të popullit shqiptar, bënë që pas një pune përgatitore, të arrihej marrëveshja midis forcave dhe rrymave të ndryshme që ekzistonin në vend, në thirrjen e Konferencës së Parë Kombëtare Nacionalçlirimtare. Një mbledhje e tillë nuk ishte e lehtë, por preokupacioni e angazhimi i forcave pjesëmarrëse ishte në kohën dhe momentin historik që kalonte vendi. Në procesin e përgatitjes së mbledhjes u kapërcyen hezitimet, ngurrimet e dyshimet për njëri-tjetrin. U arrit që në tryezën e bisedimeve të ulen njerëz me bindje, me prirje e me orientime të ndryshme ideologjike, për hir të interesave kombëtare. Konferenca siguroi një përfaqësim të gjerë, duke i dhënë të drejtën legjitime për të vepruar me përgjegjësi të lartë përpara historisë, për fatet e popullit që ishte ngritur në luftë për lirinë dhe pavarësinë e atdheut.

ORGANIZIMI I LUFTËS SË ARMATOSUR

Në shtypin e demokracisë shpesh është diskutuar se kush ishte iniciator dhe organizator e Konferencës, ishte kjo fryt i preokupimit, i punës dhe i aktivizimit të disa njerëzve të veçantë, me autoritet, me njohje e lidhje të gjëra në rrethet nacionaliste; apo ishte produkt i një mendimi të përpunuar mirë nga një forcë politike e organizuar e serioze që kishte dhe vizion për gjendjen në vend e për rrugët e zgjidhjes. Dihet se e vetmja forcë politike e organizuar në vend në atë kohë ishte Partia Komuniste. Ajo mori përsipër dhe i takon dhe merita e organizimit të Konferencës dhe dokumenteve të saj. Në atë kohë Partia Komuniste kishte shpallur hapur qëndrimin ndaj pushtuesit dhe marrë masat e para në organizimin e luftës së armatosur. Për organizimin e luftës kundër pushtuesit nuk ishin të interesuar vetëm komunistët. Shqetësim dhe gatishmëri kishin patriotë dhe atdhetarë të ndershëm, të orientimeve dhe besimeve të ndryshme nga mbarë vendi. Kjo përputhje interesash jetike, ky preokupim i përbashkët i forcave atdhetare, krijoi premisat e duhura për kontakt e dialog midis tyre, produkt i të cilave ishte edhe vendimi për thirrjen e Konferencës së Parë Nacionalçlirimtare. Ka pasur dhe ka

edhe sot mendime se Konferenca e Pezës ishte makinacion i Partisë Komuniste. Por Partia Komuniste nuk ishte si Partia Fashiste në shërbim të okupatorit. Kjo parti ishte dhe mbeti deri në fund për luftë të armatosur e vendosur për të luftuar nazifashizmin dhe çlirimin e vendit. Në Pezë kjo forcë kërkoi bashkimin e të gjitha forcave politike të vendit, komuniste e antikomuniste, zogiste e antizogiste, për të rifituar me luftën e armatosur pavarësinë e atdheut dhe për pjesëmarrje të Shqipërisë në koalicionin e madh antifashist. Në Konferencë me vullnetin e tyre dhe jo se i detyroi kush shkuan dhe nationalistë. Vetëdija patriotike, ndjenja e përgjegjësisë për fatet e vendit ishte motivi që i nxiti dhe i shtyu ata drejt Pezës. Nacionalistët patriotë pjesëmarrës në Konferencë, ishin dy herë më shumë se komunistët. Për nga pjesëmarrja, Konferenca ishte Kuvendi i vërtetë pluralist, ku morën pjesë nacionalistë të të gjithë spektrit politik, të të gjitha rrymave kryesore të vendit. Kështu rrymat u përfaqësuan me krerët e tyre: komunistët me E. Hoxhën, Y. Dishnicën, M. Gjini-shin, K. Tashkon, N. Spirun etj. dhe zogistët me A. Kupin e M. Bajraktarin. Gjysma e pjesëmarrësve përfaqësonin rrymat e tjera nacionaliste, të lidhur ose jo deri në atë kohë me komunistët dhe me luftën çlirimtare, si M. Peza, M. Xhani, H. Lleshi, Q. Harito, D. Çela, H. Begeja, S. Muço, R. Jarani, A. Cami, M. Juniku, K. Qafmolla, S. Jegeni. Në Konferencë u përfaqësua dhe gruaja shqiptare me N. Xhugini etj. Nga kjo pjesëmarrje e gjerë e pluraliste, Konferenca kishte legjitimitetin e plotë për të vendosur për çështje që lidheshin me të ardhmen e vendit.

VENDIMET DHE DETYRAT E KONFERENCËS SË PEZËS

Vendimi kryesor i Konferencës ishte bashkimi i gjithë shqiptarëve, pavarësisht nga përkatësitë shoqërore, nga dallimet fetare, nga origjina krahinore dhe nga bindjet politike, në një organizatë të përbashkët me emrin “Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar”. Fronti u ngarkua me këto detyra të rëndësishme: të ngrinte popullin shqiptar në luftë kundër okupatorit për të rifituar pavarësinë e atdheut, të udhëhiqte këshillat nacionalçlirimtare që do të formoheshin si organe lufte në zonat e pushtuara dhe si organe pushteti në zonat e çliaruara dhe të rreshtonte Shqipërinë

dhe luftën e saj në koalicionin anglo-sovjeto-amerikan. Nga shikimi i procesverbalit të Konferencës si dokumenti bazë, del se aty u hodhën për diskutim probleme të shumta. Por, dy ishin problemet e mëdha, në të cilat u ndal gjerësisht Konferenca: bashkim dhe luftë, ose bashkim për luftë. Për nevojën e bashkimit e të organizimit të popullit në luftë, nuk pati kundërshtime parimore. Për këto qysh në fillim u arrit konsensusi e mirëkuptimi i duhur, që siguroi dhe suksesin e punimeve të Konferencës. Delegatët të gjithë u shprehën për bashkim. Në diskutimet e lira u sqarua çështja se si do të bëhej bashkimi. Bashkimi do të arrihej në luftë kundër pushtuesit dhe se do të bëhej pa dallim klase, krahine, feje e ideje. Fronti i përbashkët kishte një qëllim të vetëm: të luftonte pushtuesin e huaj, për çlirimin e vendit dhe për ndërtimin e një shoqërie të re, të lirë e demokratike. Fronti kishte për detyrë të përgatiste popullin për kryengritjen e përgjithshme të armatosur, e cila do të niste e zhvillohej nga njësitet guerile e më pas me çeta. Nga kjo luftë do të dilte Shtabi i Përgjithshëm dhe do të krijoheshin Ushtria e rregullt Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar.

ÇËSHTJA E REGJIMIT POLITIK

Në Konferencë u trajtua dhe çështja e regjimit politik. Të gjithë delegatët u shprehën se regjimi i ri në Shqipëri duhet të ishte regjim demokratik. Në Konferencë u ngrit dhe çështja e Zogut, ku u konkludua që kjo çështje duhet t’i lihej në dorë popullit për të vendosur sipas dëshirës dhe vullnetit të tij. Abaz Kupi, që përfaqësonte në Konferencë zogistët, deklaroi se “unë kërkoj Shqipërinë njëherë e jo Zogun. Në qoftë se populli e do, do ta vendosë”. Në përfundim u arrit marrëveshja se karakteri demokratik i regjimit, që kërkohej nga të gjithë delegatët, të shprehej në fjalët në luftë për “Shqipërinë e lirë, të pandashme, indipendente e demokratike”. Ndërsa për formën e regjimit, këtë e vendoste populli pas luftës. Qeverisja e vendit gjatë luftës do të kryhej nëpërmjet këshillave nacionalçlirimtare, të cilat do të shërbenin njëkohësisht si organe të pushtetit të ri dhe si organe të bashkimit, të organizimit e të mobilizimit të popullit në luftë.

Konferenca diskutoi dhe çështjen e Kosovës, ku delegatët njëzëri

NDERI I KOMBIT



PARLLAKU, GJENERALI QË FITOI LAVDINË DHE PAVDEKËSINË

• *Në spiralet e historisë, gjeneral Parllaku ka ditur të lakohet me dinjitet, duke pasur si kolonë bazë përkushtimin kombëtar shqiptar dhe progresin shoqëror, si thelb i motivimit që gëlonte shpirtin e tij progresist e liridashës*

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Gjashtë vjet më parë (16 shtator 2029) u largua për në botën e përtejme gjenerali legjendë në kufirin e tri kohëve, Rrahman Parllaku – Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit. Ai u largua vetëm fizikisht pasi shpirtërisht është në mendjet dhe zemrat familjarëve, të miqve e shokëve të shumtë nga e gjithë Shqipëria.

Gjashtë vjet më parë, kur sapo kishte mbushur një shekull jetë, atij ju festua me madhësi ditëlindja jubilarë shekullore me disa veprimtari të larmishme. E meritonte, sepse Ai vinte në kapërcyellin e shekullit të jetës së tij, me profilin e burrështetësit me bukuri të rrallë fizike e shpirtërore dhe me memorie të freskët, si memoria historike e kombit. Pesë muaj pas festimit të kësaj ditëlindje, ai iku për në botën e përtejme, duke lënë pas për brezat testamentin e atdhedashurisë.

Para një viti (me 17 prill 2024), në një Akademi Përkujtimore, që OBVL organizoi në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave Ai u përkujtua si sfidanti i kohërave. Sepse Ai sfidoi varfërinë në bjeshkët e Sharrit, sfidoi pushtimin e vendit me armë, shpirt e zemër; luftoi për çlirimin e Shqipërisë e të Kosovës, sfidoi diktaturën dhe u la brezave një shembull të madh virtyti dhe idealizmi. Gjenerali që “u fik në paqe dhe iku në këmbë” (siç shprehet gjeneral Piro Ahmetaj), iku duke i lënë familjes, bashkëluftëtarëve e bashkëpunëtorëve, shokëve e miqve në gjithë hapësirën mbarëshqiptare të vetmin testament, atë të atdhedashurisë...

Gjeneral Parllaku ishte ndër të paktët partizanë që jetoi dhe dëshmoi histori të tri kohëve, të organizatorit e drejtuesit të Njësiteve guerile në qytetin e Vlorës, të partizanit e luftëtarit antifashist, të heroit e komandantit ushtarak dhe atë të persekutimit komunist. Ai ia doli mbi të gjitha furtunat e jetës. Doli fitimtar nga Lufta Antifashiste, doli gjallë nga burgu komunist, doli fitimtar në luftën për pavarësinë e Kosovës dhe deri para gjashtë vitesh ishte gjenerali më i vjetër, por me mendje të re, që mbështeste anëtarësimin e Shqipërisë dhe të ushtrisë shqiptare në NATO dhe integrimin e saj në BE.

Vetëm para gjashtë vitesh, me rastin e 100-vjetorit të lindjes, Bashkia e Tiranës e nderoi atë me titullin “Simbol i qytetit të Tiranës” (ndërkohë që në 95-vjetorin e lindjes ish-Presidenti i RSH Bujar Nishati e dekoroi me titullin e lartë “Nderi i Kombit”). Pasi kishte marrë më parë “Qytetar Nderi” i komunës së Kuveleshit, “Qytetar nderi” i Bashkisë Shijak, “Mirënjohja” e Këshillit të Qarkut Tiranë dhe “Qytetar Nderi” i Qarkut Kukës, Bashkia e Tiranës e vlerësoi Parllakun si një nga figurat emblematike të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që sfidoi edhe regjimin e diktaturës komuniste, si simbol i gjallë i kujtesës patriotike, qytetare dhe historike. Dhe në të vërtetë, ai qe kthyer në simbol të gjallë të kujtesës patriotike, qytetare dhe historike. (Edhe në moshën 100 vjeçare mbante përmendësh vargjet e poemës “Lahuta e Malcis” të Fishtës).

Shqiptarët ndihen krenarë me jetën dhe veprën e “Heroit të Popullit” dhe “Nderit të Kombit”, që bëri gjithçka në shërbim të atdheut e kombit. Prandaj, edhe vlerë-



simet dhe nderimet ndaj veprës së gjeneralit janë plotësisht të merituar.

Me gjeneral Parllakun, ndihemi krenarë të gjithë. Ai ishte dhe mbetet përmendore e gjallë e traditës dhe e virtytit familjar të trashëguar ndër shekuj.

Opinion i publik ka mirëpritur edhe librat e ndryshëm të shkruar nga gjenerali, siç është ai me titull: “Mirënjohje familjeve vlonjate që më mbajtën si birin e tyre”, “Kosova, ëndrra e jetës sime”, dhe librin me shtatë kapituj në 466 faqe “Një shekull në memorie”.

Me një kujtesë të jashtëzakonshme, me një mendjemprehtësi të madhe, gjeneral Parllaku ka bërë analiza brilante të situatave të vështira e delikate që ka kaluar vendi dhe ushtria jonë. E veçanta e gjithë “ligjëratave” të tij në shtypin e kohës dhe në veprimtari promovuese të librave kushtuar Luftës Nacionalçlirimtare e heronjve të saj, ka qenë gjykimi i tij tepër i saktë, konciz, realist, pa mllefe, pa paragjykime... Ai e ka vlerësuar gjithnjë lart Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, arritjet dhe përpjekjet e popullit jo vetëm në rindërtimin e Shqipërisë së pasluftës, por edhe ato në fushën e arsimit, shërbimit shëndetësor, zhvillimit në tërësi të vendit, përfshirë edhe arritjet në mbrojtjen e fuqizimin e ushtrisë...si dhe këto vite të demokracisë e pluralizmit.

NGA JETA E KËTJ MATUZALEMI NA ULET KËMBËKRYQ HISTORIA

Nga jeta e këtij Matuzalemi na ulet këmbëkryq historia. Nga lufta dhe përkushtimi i tij atdhetar na vjen një model për t'u ndjekur... Nga veprimtaria e gjeneral Parllakut si veteran në këto tri dekada të demokracisë mund të mësojmë se kurrë nuk është vonë për njeriun që të bëhet mbështetës aktiv i proceseve demokratizuese të shoqërisë.

Në spiralet e historisë, gjeneral Parllaku ka ditur të lakohet me dinjitet, duke pasur si kolonë bazë përkushtimin kombëtar shqiptar dhe progresin shoqëror, si thelb i motivimit që gëlonte shpirtin e tij progresist e liridashës. Vështirë të përmbledhësh në pak radhë, në kuintesencë, motivimin e personalitetit të tij, zhvillimin konjitiv e psikomotor të këtij djaloshi që ngjitej nga Novosej i Kukësit në Tribuna të larta shtetërore, në hero të popullit të tij, në drejtues madhor ushtarak, duke ndryshuar variablat në kontekste politike në funksion të mbijetesës dhe qëndresës, nga udhëheqës i shquar në të dënuar me burg, nga triumfator në grigjë të rrezikut për jetën, nga piedestali i kuadrit të dobishëm në stigmën e “njeriut të

rrezikshëm”, ekstreme këto që provokuan në personalitetin e tij, qëndrime dhe vlera të larta politiko-shoqërore në raportin e ndjenjave të forta estetike midis dashurisë dhe urrejtjes. Këtë volumn ideor dhe estetik e përcolli përgjatë shekullit të jetës së tij, një burrë shtetar, një organizëm vital, një mendje koherente dhe një vizion largpamës dhe perspektiv.

SHEMBULL FRYMËZIMI PËR ATDHEASHURINË DHE PËRKUSHTIMIN QYTETAR

Retrospektiva dhe perspektiva kanë një prerje të artë në personalitetin e gjeneral Parllakut. Atë e përshkon frymëzimi dhe dashuria për atdheun e tij, si lajtmotiv vijues mbikohor, që çliron në rrethana tipike energji shpirtërore pozitive në luftën e jetës.

Jeta e tij është një shembëlltyrë e rrallë që na fton të kuptojmë se jeta meriton të jetohet kur luftohet fort dhe fitohet. Si një ushtarak, korrekt, i shquar, ai mbështetej në skrupuj të fortë të moralit kombëtar, me pikëvështrim të qartë dhe të kthjellët, duke ngjitur një nga një shkallët e karrierës ushtarake, si një gjigand hijerëndë që ngjitet i sigurt në bedenat e kalasë.

Kalaja e pushteteve në kohë të ndryshme dhe situata të ndryshme, pati edhe shembje morale e politike, por këto nuk e dobësuan dhe përlënë gjeneral Rrahman Parllakun, këtë soj të fortë shqiptar, që me mençuri diti të manovrojë në spiralet e rrezikshme të historisë shqiptare.

Heroi i luftës në terren, i luftës dhe përbaljes në gjyqe ushtarake, përballoi burgje e privime dhe fitoi duke merituar lavdinë dhe pavdekësinë. Jeta iu afrua Heroit herë me tufa me lule, herë duke u derdhur mbi të me tërë egërsinë e saj. Rrallë gjen shembuj të tillë të personalitetit, ku të jenë ngjizur e plazmuar në mënyrë aq mjeshtërore vetitë e karakterit të një intelektual patriot, të një drejtuesi e komanduesi të aftë ushtarak, të zgjuar dhe trim, të thjeshtë dhe të ndershmë, të bukur në trup, shpirt dhe mendime.

Ai ishte një model i ardhur nga genocidi komunist si dëshmitar i gjallë për të kuptuar dhe vërtetuar peripecitë dhe traumat që kaloi ky popull i orientuar dhe i ideologjizuar gabimisht nga rryma dhe korrente të huaja. Mbi 20 vjet në krye të Organizatës të bashkuar të Veteranëve të Luftës, me ndershmëri dhe principe të larta morale, ka kontribuar në ndriçimin e mjaft skenave dhe protagonistëve, të vërtetave dhe kërkimeve historike, duke dhënë edhe në moshë pensioni, një ndihmesë të vyer në emancipimin politiko-shoqëror e demokratik të shoqërisë. Si një lundërtar i shquar, ai e drejtoi varkën e shpëtimit duke kapërcyer me sukses tallazet e historisë deri në brigjet e paqta të demokracisë që po jetojmë. Jo vetëm gjatësia kohore e jetës, por dendësia dhe përmbushja e saj me veprime, qëndrime dhe vlera në përmbajtjen e saj, e bënë këtë figurë të lartësohet në nderimin tonë shoqëror, ku zëri dhe mesazhet e tij dëgjohen deri në organizata famoze ndërkombëtare. Në këtë vështrim, gjeneral Rrahman Parllaku përbën një shembull frymëzimi për atdhedashurinë dhe përkushtimin qytetar.

PORTRET

PROFESIONALIZMI I DOKTOR ISMAIL FETËS KA QENË KULMOR

DOKTOR ISMAIL FETA

KIRURGU I 30 000 OPERACIONEVE

PROF. DR. HAJRI SHEHU

Doktor Ismail Feta është kirurgu i Spitalit Ush-tarak (sot Spitali Universitar i Traumës) që në 40 vjet punë ka bërë 30 000 operacione. Sikur edhe, thjesht pritje zyrtare të ishin, janë vërtet shumë. Dhe doktori nuk mjaftohej vetëm me operimin. Do ta ndiqte pacientin derisa ta përcillte në këmbë të veta e t'i uronte udhëmbarrën: Çdo pasdite, rruga e doktorit ishte shtëpi-spital për të parë të operuarin. Dhe të operuarit kanë qenë 30 000.Doktori ishte mjeshtër i operacione-ve të stomakut, mëlçisë etj. Ishte specializuar në Shën Petërburg të Rusisë e më pas, më 1971-1972, në Kinë – për kirurgjinë e mëlçisë së zezë. Në Kinë ka kryesuar tërë grupin e kirurgëve shqiptarë. Me vlerësimet më të larta flasin të gjithë ish-kolegët e tij: Kirurg i shkëlqyer, i rrallë. Gishtërinjtë e tij, - ka thënë ish-drejtori i Spital-it të Përgjithshëm Usharak, prof. Veli Toto, - dukeshin sikur vallëzonin në barkun e hapur të pacientit. (Gazeta “Koha jonë”, 1 nëntor 2003, f. 21). Një tjetër koleg i tij, prof. Spiro Dede thotë: Unë jam i lumtur që kam punuar me një koleg të këtyre përmasave.

Profesionalizmi i doktor Ismail Fetës ka qenë kulmor. Në vitet '70, - mbaj mend, - ka shkruar gazeta “Bashkimi”: Doktor Ismail Feta bën operacionin e 140-të botëror. Rasti ka qenë ky: Një vajzë rreth 10-vjeçe bie nga mani. Tri të katërtat e mëlçisë ishin dëmtuar. Gjendja e vajzës ishte shumë e rëndë. E fut në sallë të operacionit vetë kirurgu, dr. Ismaili. Operacioni del me sukses. Duart e doktor Ismailit e shpëtuan vajzën. Kështu është shkruar atëherë në gazetën “Bashkimi”. Mrekullia është se vajza vogëlushe është bërë mjeke. Mrekullia e parë që e doktor Ismail Fetës. Kirurgu i talentuar ka qenë edhe shef i pavijonit të kirurgjisë. Ka qenë edhe drejtor i Shëndetësisë së ushtrisë. Dhe ka shkëlqyer edhe atje. Me dijen dhe fjalën e tij. Por duart e tij qenë të lindura për kirurgji.

Tregon i biri, Bashkimi: Pasi i operojnë dikujt djalin e djali del nga spitali, burri troket në derën e mjekëve e u thotë: Kush ma ka operuar djalin se dua ta falënderoj? I thonë: Ekipi. Ai kujtoi se mjeku e kishte emrin Ekip. Po, ku mund ta gjej doktor Ekipin? Doktor “Ekipi”, - i thonë është ky këtu - doktor Ismail Feta. I punës e i thjeshtë me pacientët. I thjeshtë e jorrahagioks me të afërmit e pacientëve. Po të mos më marrin si jonormal, - tha burri, - dal e thërras rrugëve të Tiranës: Rroftë doktor Ismail Feta! Doktorin e adhuronin pacientët. Do të operohej një burrë, - tregon përsëri Bashkimi. Dyshohej për sëmundje jo të mirë. Dhe pacienti ngulmonte: Edhe po vdiqa, s'ka gjë; vetëm të më operojë doktor Ismaili.

Doktor Ismailin e kam mik. Dhe nga anët e mia thonë: Zgjidhe mikun më të mirë se vetja! Prandaj e kam zgjedhur. Dhe në vitin 1976, doktor Ismaili ka qenë në shtëpinë time, në katundin Vleshë për një kthim buke, siç quhet andej. Dhoma e epërme u kthye në dhomë vizitash mjekësore. E kishin marrë vesh njerëzit dhe do-nin t'i vizitonte doktor Ismaili. Doktori ishte kirurg sto-maku, mëlçie etj. Këtë e dinin. Dhe prandaj vinin – për stomak. Dhe pastaj, pas disa ditësh a muajsh, thënie-t e tyre ishin: Qishkur më ka vizitue doktor Ismaili e më ka dhanë ilaçet, s'më dhemb ma stomaki, - thoshte njëri a tjetri. Tërë dijen e vet, teknikën e vet e dorën e vet doktor Ismaili ua dha edhe mjekëve të tjerë nga tërë Shqipëria, që specializoheshin për kirurgji në sallën e tij të opera-cionit e në pavijonin e tij. Unë njoh kirurgun e Gjirokas-trës, Roland Karalliu. Nga kirurgu i madh, Ismail Feta e mori tërë mjeshtërinë operatore. Rolandi ka bërë mbi 12 000 operacione në vitet e tij të punës në spitalin e madh të Gjirokastrës, që mban emrin “Omer Nishani”. Doktor

Ismaili ishte shpirt njeriu, shumë zemërdhembshur. Gjithmonë fjalëbutë. Po të rrudhte vetullat doktori, pra vetëm kaq, duhet ta merrje vesh se kishe bërë gabim të rëndë.


Doktor Ismail Feta ka lindur në katundin Zagrad, Pe-shkopi. Është katundi më i epërm, andej nga nxjerr dielli syrin. Ende i parritur, u rreshtua partizan në Brigadën

XVIII Sulmuese. Në ceremoninë varrimore, më 15 korrik, 2002, pas bataresë së pushkëve për të nderuar kujtimin e doktor Ismail Fetës, Artisti i Popullit, Sulejman Pitar-ka tha gjithë krenari: “Me krisma e nise (jetën), me kris-ma e bitise, o Ismail Feta.” Pas Çlirimit, pas Shkollës së Bashkuar të Oficerëve, Tiranë, ndjek shkollën e mesme mjekësore në Lubjanë (1947-1951). Studimet i përfun-don në Kiev, Ukrainë. Më 1952-1959 kryen studimet e larta për mjekësi në Akademinë Ushtarake Mjekësore “Kirov” në Leningrad (sot Shën Petërburg). Më 1958-

1959 specializohet për kirurgjinë e stomakut, patologjitë e mëlçisë, të zorrëve etj. Më 1971-1972 bën, siç u për-mend, një specializim tjetër në Kinë.

Me betimin e Hipokratit në mendje dhe në zemër, doktor Ismail Feta bëri 30 000 operacione. Ky është mjeku. Ky është njeriu. Njeriu njerëzor.

Doktor Ismail Feta është Qytetar Nderi i qarkut të Di-brës. Titullin Qytetar Nderi mund t'ia jepte edhe Tirana. Kombi – titullin: Nderi i Kombit. Për punën dhe përkushtimin në shërbim të Kombit.



REFLEKSIONE

Familja e Dëshmorit Shefki Miftar Muço është model për shoqërinë sepse na mëson si të jetojmë me nder, si të duam atdheun më shumë se veten

Modeli i Familjes së Dëshmorit

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj
Mjeshtër i Madh

Familja e Dëshmorit të Atdheut Shefki Miftar Muço në Trebinjë të Pogradecit është simbol i qëndresës, sakrificës dhe atdhedashurisë së pastër. Në këtë vend ku është bërë luftë për liri, pavarësi dhe drejtësi, kjo familje dëshmorit ka qenë mbështetja morale e fshatit, sepse përmes dhimbjes së tyre, ruan kujtesën e gjallë të bijve që dhanë jetën për një të ardhme më të mirë.

Dëshmorit Shefki Muço la studimet ushtarake për artilleri në Itali dhe u kthye në Atdhe për sakrifikuar jetën për një kauzë të madhe, për lirinë e popullit të vet, për tokën, për identitetin dhe për të ardhmen e brezave.

Kjo Familje Dëshmorit e mban me krenari këtë emër, por edhe me dhimbje të përjetshme. Vazhduesi i saj është Metjan Muço, një djalë i ri dhe energjik, me kulturë dhe vizion të qartë për kohën. Ai thekson se Familja Muço ka humbur një anëtar të familjes, një zemër, një prind, një vëlla, një bir që nuk do të kthehet më. Megjithatë, kjo familje ka qëndruar stoike, me kokën lart, sepse e di mirë se rënia dëshmorit është një çmim për një të mirë të madhe.

Kjo Familje Dëshmorit është model për shoqërinë sepse na mëso si të jetojmë me nder, si të duam atdheun më shumë se veten dhe si të sakrifikojmë për të drejtën. Kjo familje dëshmorit nuk kërkon mëshirë, por dinjitet. Lapidarin simbol të përkujtimit të rënies së dëshmorit, të prishur e rikonstruktioi, duke u bërë frymëzim për të rinjtë, për t'i edukuar me ndjenjën e përgjegjësisë dhe përkushtimit ndaj vendit.

• *Dëshmorit Shefki Muço la studimet ushtarake për artilleri në Itali dhe u kthye në Atdhe për të sakrifikuar jetën për një kauzë të madhe, për lirinë e popullit të vet, për tokën, për identitetin dhe për të ardhmen e brezave...*

Shoqëria dhe shteti kanë një detyrë të madhe morale dhe ligjore ndaj Familjeve të Dëshmorëve, për t'i nderuar, t'i mbështesë dhe t'i përfshijë në jetën publike si shembuj të vërtetë të qytetarisë.

Kujtimi i dëshmorit jeton përmes familjes dhe nëpërmjet respektit që kjo familje tregon ndaj familjarit të vet të rënë për Atdhe. Model i kësaj Familje Dëshmorit është dhe një thirrje për të mos harruar, për të qëndruar të bashkuar dhe për të ndërtuar një shoqëri që e vlerëson sakrificën dhe jeton me ndjenjën e përbashkët të përkatësisë dhe detyrimit ndaj atdheut.

Me këtë ndjenjë përgjegjësie i riu Metjan Muço me arsimi në vitet 2007-2010, Bachelor, pranë Universitetit "Medikadent", Fakulteti "Infermieri", dega "Infermieri e Përgjithshme", Ti-



Dëshmorit Shefki Miftar Muço



Metjan Muço

ranë 2016-2019, Master Profesional, pranë Universitetit "Fan S. Noli", Fakulteti "Infermieri e Përgjithshme" dega "Infermieristikë" Korçë, është zgjedhur në krye të Organizatës së Dëshmorëve të Njësisë Administrative Trebinjë.

DËSHMORI I ATDHEUT SHEFKI MIFTAR MUÇO

Lindi në Trebinjë nga babai Myftar dhe nëna Zybe në vitin 1918. Në familjen u edukua që fëmijë, së bashku me vëllain Mehmet dhe motrën Xhemiko, u mbrujtën me dashurinë për atdheun e lirinë, me traditat e larta patriotike të krahinës së Mokrës. Në 1891 at Jovan Vako u mësonte nxënësve të Mokrës së Sipërme gjuhën shqipe me alfabetin e Sami Frashërit. Pavarësia e Shqipërisë i gjeti mokrarët me shkollën e djemtë që mësonin në gjuhën shqipe. Ishin vitet e para të shtetit shqiptar të sapokrijuar. Në familjen Muço ishte kuptuar shumë mirë, se trimëria e dituria ishin krahët e fortë të lirisë e përparimit. Prandaj shkollimi i fëmijëve ishte detyrë dhe krenari për familjen. Në rrugën e arsimimit Shefkui tregoi që i vogël dëshirë, vullnet e shumë zgjuarsia duke mbaruar me rezultate shumë të mira shkollën fillore e atë plotore. Duke vlerësuar formimin e tij e regjistruan në kursin për oficer të ushtrisë mbretërore në Tiranë. Për aftësitë e spikatura në drejtim e komandim, në vitin 1937 ai filloi studimet me bursë në Akademinë Ushtarake të Romës. Në dy vjet studime të larta ai tregoi zotësi profesionale duke qenë një nga studentët e perspektivës në rrugën e karrierës e të gradave ushtarake.

Prilli i vitit 1939 kur Italia fashiste sulmoi dhe pushtoi Shqipërinë ishte një peshë e rëndë në zemrën e Shefkut dhe studentëve të tjerë ushtarakë shqiptarë, të cilët u detyruan të "inkuadrohen në radhët e pushtuesve". Me mbritjen në Shqipëri Shefkui gjeti momentin për tu arratisur duke "dezertuar" nga ushtria pushtuese fashiste italiane.

I maskuar u vendos tek të afërmit e familjes në Grabovë. Fashistët kishin shpallur kërkim për "dezertorët", por

Shefkut i ishte ndezur urrejtja dhe dëshira për hakmarje ndaj pushtuesve të pabesë. Prej Grabovës ai i shkruan letër të vëllait, Mehmetit. Jam i fshehur në Grabovë. Në momentin më të parë që do mundem, do të shkoj në Gribë tek teza. Dhe ashtu bëri. Shkoi në Gribë ku u inkadrua në çetën e krijuar nga Reshit Çollaku. Së bashku punuan me njerzit në gjithë krahinën, për të ngjallur dhe organizuar luftën antifashiste. Nga çetat, kur numri i luftëtarëve u rrit mbi 300 vetë, u formua më 17.5.1943 në fshatin Pleshisht të Mokrës batalioni i Mokrës.

Reshiti duke ia njohur Shefkut aftësitë luftarake dhe sidomos njohuritë për armët e rënda e emëroi komandant të kompanisë së armëve të rënda. Batalioni partizan i Mokrës, kishte bazat e tij në krahinë, si shtëpia e Liko Gjona në Laktesh, te Maro Mokra në Potgozhan, në Pleshisht te Thanas Maçolli, te Lia Tona në Kalivaç, te Myftar Muço në Trebinjë etj.

Batalioni kreu luftime të ashpra me armikun e tradhëtarët në krahinë, si në Dunicë, në pritën e Pojskës në 16 korrik 1943 etj. Në Pojskë u vra komandanti Reshit Çollaku dhe Ptoleme Aleksandër Xhuvani, Siri Hysen Kodra, Spiro Theotaq Gjijnuri, Ali Hysen Arapi, Petrit Shaban Blloshmi, Koli Gjokë Gusho, Isuf Dilaver Leka, Dilo Sulejman Nezha dhe Arif Maksut Kuka.

Pas kapitullimit të Italisë fashiste Shefkui me trimëri vazhdoi luftimet edhe kundër nazistëve gjermanë. Ishte vetëm 26 vjeç, në lulen e rinisë, kur në 11 korrik të vitit 1944 u vra heroikisht në luftimet për çlirimin e qytetit të Pogradecit.

Në nderim të dëshmorëve të LANÇ shkolla e fshatit Trebinjë në Mokër mban emrin "3 dëshmorët". Në pllakën përkujtimore tek lapidari i dëshmorëve janë të shkruar emrat: Shefki Muço, Nikolla Marolli dhe Bendo Buzo

Grupi polifonik i Mokrës ka kënduar këngën e dëshmorit Shefki Muço dhe në vendin ku ra pranë qytetit të Pogradecit ngrihej dhe lapidari që përjetësonte dëshmorët e rënë në korrik 1944, midis tyre dhe Shefki Muço.



LIBRI

Prof. XHEMAL MEÇI BOTON LIBRIN E RI

PUKA PËR LIRI E PAVARËSI DHE DËSHMORËT E SAJ

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Në kuadrin e 80 vjetorit të Batalionit Partizan “PUKA”, studjuesi i mirënjor, prof. Xhemal Meçi – Mjeshtër i Madh boton vëllimin e parë të librit “Dëshmorët e Atdheut të Pukës”.

Ky botim, që siç shprehet autori është i nxitur prej kerkesave të Familjeve të Dëshmorëve të Atdheut të Degës Pukë dëshmon për përpjekje serioze, sepse që në pamje të parë është gjithpërfshirës, duke evidentuar dhe portetizuar të rënë për liri e pavarësi që prej kohësh sa më të herëshme.

Dhe nuk janë pak, por plot 84 emra të atyre që kanë rënë në altarin e lirisë së kombit.

Qëllimisht autori Xh. Meçi ka zgjedhur si parathënie shkrimin e nënkryetarit të OBVLP Muharrem Gjoka-Mjeshtër i Madh (Gazeta “Veterani, maj 2024), duke ju përmbytur qëndrimit të palëkundur të organizatës tonë se “Respekti dhe nderimi për dëshmorët është shenjë e pjekurisë dhe fuqisë së një kombi dhe se respekti për të kaluarën është një investim për të ardhmen”.


Këtë respekt dhe nderim autori i këtij libri e shpreh më së miri duke portretizuar 84 dshmorët e atdheut të Pukës, të cilët, siç shkruan ai në kopertinën e librit, janë dhe do të mbeten nderi dhe krenaria e kombit.

Për faktin se çdo kohë ka dëshmorët e saj dhe ne i nderojmë ata pa dallim, duke punuar çdo ditë për përmbyshjen e idealeve të tyre për Shqipërinë, për të qenë sa më bindës për lexuesin, prof. Xhemal Meçi e shkruan këtë libër në referim të një bibliografie mjaftë të pasur me 35 tituj librash, artikujsh e studimesh.

Libri ka një ndërtim kompozional të admirueshëm me një ndarje me katër kapituj: Atdhetarët që kanë dhënë jetën për mbrojtjen e tërësisë së trojeve tona iliro-arbërore; Dëshmorët partizanë antifashistë; Dëshmorët e rënë në vitet e pasçlirimit për të vendosur rend e siguri për popullin dhe Dëshmorët oficerë e punonjës të Policisë së Shtetit të rënë në krye të detyrës.

Mbi këtë bazë libri paraqet lehtësi studimi. Në faqet e tij, luftërat për çlirimin e atdheut, gjaku i derdhur, jetët e flijuara dhe sakrificat sublime për lirinë e tij, janë gdhendur si dëshmia monumentale e një populli që ka luftuar në mënyrë të paepur me pushtuesit gjatë gjithë historisë së tij.

“Gjaku i dëshmorëve ka rrjedhë prej shekujsh për liri e pavarësi dhe mbrojtjen e trojeve arbërore, prandaj sillet në memorie si model heroizmi Oso Kuka, që aq madhër-



ishëm e ka dhënë veprën e tij legjendare, Fishta të ‘Lahuta e malcis’ si shqiptarit i ka pas hije në shekuj:


‘Aman falë i kjosim Zotit/ Kur i ka dhan zjarr barotit/ Se ç’asht dridh Vrania e shkret/ Se ç’a hedh kulla përpjet/ Sa dhe liqeni ka gjëmue!’ (fq.23-24).

Më tej autori shkruan se një prej trimave të Oso Kukës që dha jetën në atë kull baroti ishte edhe ... “Çoku i Kol Mar”Drinit prej Kabashit t’Dukagjinit (Pukë), trim i çartun, trim si zanë!”. Kështu shkruan autori i këtij libri edhe për Zenel Mustafë Agën e Iballës me Marash Markun e Frrok Kolë Gjergjin-dëshmor i atdheut, drejtues i Shtatë Bajrakëve të Pukës gjatë kryengritjes së përgjithshme 1912, përkrahës të Bajram Currit e Hasan Prishtinës, pjesëmarrës në Besëlidhjen e Shkupit, gusht 1912.

Kësisoj prof. Meçi si studjues skurpuloz i historisë rrok një hark kohor prej më se një shekulli, në përshkrimin e heronjve dhe dëshmorëve të atdheut që qëndrojnë dinjitetshëm në panteonin e vlerave.

Duke bërë pjesë të këtij libri fjalën që ka mbajtur në Simpoziumin e parë për dëshmorët e atdheut Pukë, të datës 9 qershor 2022, Prof. Xhemal Meçi e njeh lexuesin edhe me dëshmorë të tjerë, si: Derman Aga e Kadri Sokoli të Iballës, rënë në mbrojtje të Plavës e Gucisë; Salih Tahiri rënë më 1918 (përjetësuar edhe nga kënga popullore: “Krisi pushka, ushtoi Drini/ ke ka vra Salih Tahiri), si dhe Zekë Nikoll Curri e Prengë Curri me nemceli; Çup Qafa - Fushë Arës e Mustafë A.Brahaj, rënë në luftë me ushtrinë serbe, shpallur “Dëshmorë të atdheut”.

Në këtë libër gjejmë edhe vlerësimin e Prof.asoc.dr. Bernard Zotaj



- Mjeshtër i Madh, i cili në një përmbledhje të dëshmorëve të Pukës (dhe atyre të pashpallur brenda e jashtë rrethit Pukë, deri në kufijtë jugorë, si edhe në Kosovë) flet për dëshmorin Shaban Halil Uka, rënë me 7 shtator 1943 për çlirimin e Gjakovës, si dhe për Ndue D. Gjokën rënë dëshmor me 11 dhjetor 1944 në Deçiq të ish-Jugosllavisë, etj, etj.

Nga ky libër ja vlen ta perifrashojmë Prof. asoc. dr. Bernard Zotaj – Kryetar i Shoqatës së Historianëve Ushatarakë, se “Në shkrimet për dëshmorët e Pukës gjenden mjaftë luftime ku janë treguar akte të larta heroizmi dhe gjak i derdhur për të mbrojtur vendin nga pushtuesit e shumtë në shekuj”.

Mjaftë të arrirë janë në këtë libër shkrimet me titujt: “Bije Vokshi për varrezat e dëshmorëve të atdheut”; “Dëshmorë të atdheut (të pashpallur)”; “Këngë për Pal Marashin e Qelzës”; “Kuvendi e Besëlidhja e Pukës për çlirimin e vendit”; “Mic Sokoli”; “Rrustë Rexhep Kabashi”; “Puka, tokë e zjarrit ndaj pushtuesve serbë”; “Pista me topin e Dardhës deri në kufijtë e legjendës”; “Halil Hasani – ‘Mic Sokoli’ i Malziut”, shkrimet për dëshmorët Ndoc Mark Deda, Mëhill Mark Deda e Gjergj Mark Deda, etj.

Në këtë libër ka referenca edhe nga Dr. Gjergji Velo – Kryetar i Organizatës së Dëshmorëve të Atdheut të Shqipërisë, nga Kryetari i Organizatës “Dëshmorë të atdheut” Dega Pukë, z. Rasim Cina, nga Ing. Kol Deda me një kontribut të çmuar në përkujtimin dhe evidentimin e dëshmorëve, si dhe nga Marte Gjergji, mësuese “Familje Dëshmori”.

Në tërësinë e tij, ky libër është një kontribut madhor i studiuesit Xhemal Meçi për pasurimin e fondit të letërsisë dokumentare shqiptare.

OPINION

VETËM FUQIA E USA – TRUMP NDALON LUFTËN E III BOTËRORE

- *Historia na tregon se luftërat nisin nga veprimet, mosveprimet dhe oshilacionet e diktatorëve gjakatarë, autokratëve të gjithëpushtetshëm, si dhe shpërfillja e mësimave nga luftërat e mëparshme. Në ditët e sotme, teknologjia (IA) e bën luftën më të paparashikuar, më të pamëshirshme dhe më shkatërrimtare, ose mund të jetë “edhe e fundit për njerëzimin”.*
- *Si garanci në dështimin me sukses të reformave të sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare, janë: “pluralizmi fasadë, përdhosja e zgjedhjeve dhe poshtërimi i Kuvendit të Gazëve dhe zengjinëve; dalldisjet bolsheviqe nga superfitorja e gjithëpushtetit si dhe mjerimi i opozitës nga humbja e (4-ërt) radhas”. Në të kundërt, mbetet kritik rikthimi i demokracisë funksionale, balancave kushtetuese, dashurisë për atdheun, përkushtimi dhe përgjegjshmëria ndaj interesave kombëtare, si dhe “besimi dhe mirënjohja” ndaj partneritetit strategjik me SHBA, NATO*



Gjeneral © PIRO AHMETAJ*

Në opinionin e para disa javëve (publikuar nga mediat shqiptare), trajtova disa pikëpyetjeve me peshë gjeopolitike si: A ndodhemi në prag të Luftës së Tretë Botërore? Kush mund të jenë pasojat fatale dhe çfarë peshe mbart Inteligjenca Artificiale, robotët, dronët dhe fuqia kibernetike? A do të ketë fitues, apo vetëm të humbur në një luftë e tillë etj.! Ndërsa në këtë opinionin (si vijim ...) do t'ju jap përgjigje, pse: “vetëm/falë superfuqisë së USA-Trump nuk do të ketë Luftë të Tretë Botërore”, si dhe pesë rekomandime gjeopolitike për superfuqizim, mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave mbarëkombëtare.

Pikë së pari, përtej natyrës së kërcënimeve, fuqisë vdekjeprurëse dhe peshës përcaktuese që mbartin në fatin e luftës së ardhshme Inteligjenca Artificiale, raketat, robotët, dronët, gara e frikshme për armatime të gjeneratës së fundit, si dhe ulërimat/propaganda bolsheviqe, më duhet të konfirmoj se në vlerësimin tim përmblledhës: “duke konsideruar sulmin shembullor që fuqia shkatërrimtare e SHBA (6 avion B-2 me kosto 2 bilionë dollarë; 37 orë fluturim; 12 bomba GBU-57 (14 tonë secila); 10-ra raketa Tomahaëk dhe mbi 125 avionë F-35) realizuan operacionin ‘më të suksesshëm të historisë së njerëzimit’ ndaj bazave bërthamore të Ajatallahut të Iranit, i cili gjatë 34 viteve kërcënonte me shfarosje nga faqja e dheut të Kombeve, kulturave dhe Shteteve sovraane”! Thënë këtë, më duhet ta nënvizoj se asnjë shtet tjetër (përfshi Kinën dhe Rusinë) dhe as koalicion shtetesh (BRICS) nuk zotëron kapacitete për të real-

izuar operacione të ngjashme ose të përafërta, qoftë sulmi apo mbrojtjeje (në dy raste mbi 98% e raketave të Iranit dhe dronëve u asgjësuan në ajër! Padyshim, ky sulm ishte edhe mesazh i fuqisë vdekjeprurëse të USA ndaj diktatorëve gjakatarë si dhe të shkalluarve nga fuqia e të gjithë-Pushtetit (Putinit, Kim Jong, etj.). Në shtesë, përsëris se mbetem besimplotë se: “Vetëm falë superfuqisë ushtarake të pathyeshme, të pakonkurrueshme dhe vdekjeprurëse të USA si dhe leadershipit të fortë të Trump, bota nuk do të rrokulliset në fatalitetin e Luftës së 3 të Botërore”. Pra, falë fuqisë së SHBA-Trump, jo lufta, por paqja, rendi global i sigurisë, vlerat e qytetërimit dhe demokracia funksionale do të triumfojnë mbi neo-nazistët, neo-stalinistët, neo-Millosheviçët si dhe ndaj shteteve dhe organizatave terroriste”!

Së dyti: Së dyti: “Kush nuk e kujton të kaluarën, është i dënuar ta përsërisë atë”, thoshte filozofi Spanjoll, G.Santayana. Vrasja e princit austriak (1914), në Sarajevë ndezi luftën e I-rë. “Zjarri nuk vjen nga shkëndija më e madhe, por nga e vogla mbi barin e thatë”, thonë francezët. Para Luftës së II-rë, Evropa shijonte “La Belle Époque”. Pra lulëzim industrial dhe ekonomik, por, nën këtë fasadë, fshiheshin tensione të mëdha: “garë e frikshme armatimesh, interesa koloniale dhe aleanca të ndërlikuara”.

Pse ndodhemi në një situatë të ngjashme? Rendi ndërkombëtar është bërë edhe më i brishtë pasi “ekstremistët dhe interesat nacionaliste” po ringjallen. Lufta e II-të, mbi 70 milionë të vrarë dhe për herë të parë u përdorën bombat bërthamore në Hiroshimë dhe Nagasaki. Lufta e Ftohtë (1945-90) paqja u imponua nga: “garë armatimesh, tensione të forta si dhe frika nga një katastrofë planetare”. SHBA dhe BRSS u ndanë në kapitalizëm vs. komunizëm, si dhe në aleancat ushtarake, NATO dhe Varshavë!

Fatëkeqësisht edhe Sot, në vend të plumbave po përdoren embargot, në vend të lëvizjes së lirë po ngrihen mure, në vend të tregtisë së lirë po vendosen tarifa. Historia përsëritet: “sanksionet, luftërat tregtare dhe kontrolli mbi burimet e rralla janë kthyer në armë ekonomike”.

“Çfarë mund/duhet të bëjnë vendet e vogla si RSH, Kosova, etj., në



rast të një lufte botërore”?

Për më konkretisht në vijim gjeni edhe pesë rekomandime strategjike:

1. Historia na tregon se luftërat nisin nga veprimet, mosveprimet dhe oshilacionet e diktatorëve gjakatarë, autokratëve të gjithëpushtetshëm, si dhe shpërfillja e mësimave nga luftërat e mëparshme. Në ditët e sotme, teknologjia (IA) e bën luftën më të paparashikuar, më të pamëshirshme dhe më shkatërrimtare, ose mund të jetë “edhe e fundit për njerëzimin”.

2. Asnjë vend nuk i mbijeton dot i vetëm një lufte botërore, por “sidomos shtetet e vogla nuk e kanë luksin të bëjnë gabime strategjike”, thoshte Kissinger. Kështu, as nuk duhet ta mendojmë rikthimin të marrëzisë e “mbrojtjes me forcat e veta” që për 45 vjet e poshtëroi kombin si dhe i rraskapiti shqiptarët! Në rast të një përballje fatale, na duhet të forcojmë edhe më tej bashkëpunimin strategjik me SHBA dhe NATO-n. Pra, për mbijetesën, mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave kombëtare na duhet: “aleanca të forta, kontribute modeste (por të spikatura) si dhe diplomaci aktive”.

3. Duke duartrokitur “marrëveshjen mes Kroacisë, Kosovës dhe RSH në fushën e mbrojtjes”, do t'i këshilloja vëllazërisht aktorët politikë dhe faktorët Shtetërorë në Tiranë dhe Prishtinë: “të përulen në gjunjë para historisë së përgjakshme dhe përgjegjësiive shtetërore”, për t'i dhënë jetë platformës: “2-Shtete Sovrane, 1-Komb i Vetëm”, duke e konfirmuar në Uashington, Bruksel etj., që “edhe pse e vonuar” nuk kërcënon asnjë vend (përfshi Serbinë), por do të kontribuojë si një balancë racionale për

paqen afatgjatë si dhe integrimin euroatlantik të Ballkanit Perëndimor.

4. Rritja e shpenzimeve për mbrojtjen nga 2% në 5% deri në 2030 nuk është kurrësi “për ta marrë me të mirë Presidentin Trump”, por domosdoshmëri kritike për të transformuar sistemin e sigurisë dhe mbrojtjes së RSH, në përputhje me konceptin e ri të mbrojtjes kolektive, duke përditësuar dhe modernizuar aftësitë operacionale të FARSh-së për përmbytjen e misionit kushtetues: “mbrojtjen e integritetit territorial (neni 5); zhvillimin e interesave kombëtare, promovimin e vlerave euroatlantike si dhe përmbytjen e detyrimeve në NATO”!

5. Si garanci në dështimin me sukses të reformave të sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare, janë: “pluralizmi fasadë, përdhosja e zgjedhjeve dhe poshtërimi i Kuvendit të Gazëve dhe zengjinëve; dalldisjet bolsheviqe nga superfitorja e gjithëpushtetit si dhe mjerimi i opozitës nga humbja e (4-ërt) radhas”. Në të kundërt, mbetet kritik rikthimi i demokracisë funksionale, balancave kushtetuese, dashurisë për atdheun, përkushtimi dhe përgjegjshmëria ndaj interesave kombëtare, si dhe “besimi dhe mirënjohja” ndaj partneritetit strategjik me SHBA, NATO.

(Marrë nga Gazeta “PANORAMA”, 8 gusht 2025)

* Autori: Gjeneral © Piro Ahmetaj: Senior Ekspert për Sigurinë Kombëtare, Rajonin Ballkanit si dhe marrëdhëniet me USA/NATO - Ish zv/ShShPFA dhe Këshilltar i Presidentit të RSH.

83-VJETORI

Rreshtimi i Shqipërisë përkrah koalicionit antifashist anglo-sovjeto-amerikan

KONFERENCA QË MISHËRON VLERAT MË TË LARTA TË KOMBIT TONË E TË UNITETIT

Tetëdhjetëetë vjet më parë, më 16 shtator 1942 u mbledh në Pezë Konferenca e Pezës, që përbën një ngjarje mjaft të rëndësishme dhe të madhe historike për popullin shqiptar. Për nga qëllimet dhe vlerat historike, Konferenca e Pezës është vendimmarrje e njëjtë politike, si Lidhje Shqiptare e Lezhës, organizuar nga Skenderbeu më 2 mars 1444 në Lexhë dhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit, e mbledhur më 10 Qershor 1878 në Prizren.

Qëllimi ka qenë i njëjtë: organizimi i luftës së popullit shqiptar për çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj.

Konferenca e Pezës, përbën një ndodhi historike mjaft të madhe në historinë e popullit shqiptar, pasi në të u mbledhën përfaqësuesit e të gjitha forcave politike të vendit dhe përpunuan platformën e përbashkët të luftës kundra pushtuesit fashist për çlirim kombëtarë.

Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të forcave antifashiste shqiptare, me synim që të formohet një front i përbashkët lufte kundër okupatorit. Më vonë ky organizim mori emrin Fronti Nacionalçlirimtar.

PROTAGONISTËT

Protagonistë të këtij kuvendi ishin 17 delegatë, përfaqësues të krahinave dhe besimeve të ndryshme fetare, klasave dhe shtresave me bindje politike nga më të ndryshmet. Pjesëmarrësit vinin nga rrymat e ndryshme politike. Ndërmjet tyre ishin: Abaz Kupi, Aziz Çami, Halim Begeja, Haxhi Lleshi, Is-

mail Petrela, Mustafa Xhani, Myslim Peza, Ndoc Çoba, Ramazan Jarani, Skënder Jegeni dhe Skënder Muço. Nga PKSH-ja morën pjesë Ymer Dishnica, Mustafa Gjinishi, Koço Tashko, Enver Hoxha, Nako Spiru dhe Nexhmije Xhuglini.

Që të gjithë i miratuan vendimet e Konferencës. Ndërsa Kamber Qafmolla nuk mori pjesë në konferencë. Në këshillin drejtues u zgjodhën 7 persona: 1. Enver Hoxha, 2. Ymer Dishnica, 3. Mustafa Gjinishi, të tre komu-

nistë, 4. Myslim Peza, 5. Abaz Kupi, 6. Ndoc Çoba e 7. Kamber Qafmolla, që të katër nacionalistë, patriotë pa parti.

VENDIMET E KONFERENCËS SË PEZËS

- Konferenca mori disa vendime të rëndësishme:
- Krijimin e Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, ku do të bënin pjesë antifashistë pa dallim feje, krahine dhe ideje.

Në Konferencë u trajtua dhe çështja e regjimit politik. Të gjithë delegatët u shprehën se regjimi i ri në Shqipëri duhet të ishte regjim demokratik. Konferenca diskutoi dhe çështjen e Kosovës, ku delegatët njëzëri u shprehën për zgjidhjen në bazë të vetëvendosjes së lirë, si e parashikonte Karta e Atlantikut dhe të drejtën e vetëvendosjes kosovarët dhe shqiptarët e viseve të tjera do ta fitonin duke u hedhur në luftë kundër fashizmit



- Mobilizimin e popullit në luftë kundër pushtuesve fashistë
- Ngritjen e Këshillave Nacionalçlirimtarë në të gjithë vendin.
- Rreshtimin e Shqipërisë përkrah koalicionit antifashist anglo-sovjeto-amerikan.
- Krijimin e një Shqipërie të lirë, të pavarur e demokratike pas lufte.

Sa për çështjen e rikthimit të mbretit Zog, u vendos që vendimi të merrej pas lufte, nga vetë populli shqiptar. Lidhur me çështjen e Kosovës, u arrit në përfundimin që ajo të zgjidhej pas lufte, duke u mbështetur në të drejtën e vetëvendosjes.

Në fund të punimeve konferenca zgjodhi Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, me kryetar Kamber Qafmollën, sekretar Mustafa Gjinishin dhe anëtarë Ndoc Çobën, Myslim Pezën, Abaz Kupin, Enver Hoxhën dhe Ymer Dishnicën.

Konferenca e Pezës mishëron vlerat më të larta të kombit tonë dhe të unitetit. Për shkak të vizonit të tyre largpamës, burra dhe gra u ngritën mbi interesat e asaj kohe dhe u bënë bashkë për të mirën e kombit që ishte në rrezik. Misioni ynë sot është mbajtja gjallë e mesazheve të kësaj dite, të mesazheve që Konferenca e Pezës ka përcjellë ndër vite edhe tek brezi i ri.

Konferenca e Pezës , ngjarja më madhore e LANÇ-it

vijon nga faqja 3

u shprehën për zgjidhjen në bazë të vetëvendosjes së lirë, si e parashikonte Karta e Atlantikut dhe të drejtën e vetëvendosjes kosovarët dhe shqiptarët e viseve të tjera do ta fitonin duke u hedhur në luftë kundër fashizmit.

Lëvizja Nacionalçlirimtare e Shqipërisë nuk do të kursente ndihmën e saj, që në Kosovë të organizoheshin për luftë dhe të krijonin këshillat e tyre nacionalçlirimtare. Vendimet e Konferencës, patën jehonë në zhvillimet politike në vend. Kështu u rritën me shpejtësi radhët e Frontit Nacionalçlirimtar me patriotë nga i gjithë vend. U shtuan e u zgjeruan njësitë partizane me luftëtarë të rinj nga të gjitha krahinat.

Zhvillimet pozitive patën ndikim dhe në arenën ndërkombëtare. Pas Konferencës së Pezës, në dhjetor 1942, Fuqitë e Mëdha Aleate (SHBA, BS dhe Anglia) njohën zyr-

tarisht luftën e popullit shqiptar dhe Shqipërinë si pjesëtare të Koalicionit Antifashist Botëror.

Përvojë mësimesh

Konferenca si ngjarja më e madhe e LANÇ-it sjell një përvojë mësimesh me vlerë në ditët tona.

Te kjo ngjarje çdo shqiptar e çdo forcë politike gjen mësim për të kontribuar në zgjidhjen e halleve e të problemeve të shumta me të cilat ballafaqohet sot. Peza dhe e gjithë Shqipëria bën thirrje për të respektuar bindjet dhe përkatësitë politike, shoqërore e fetare, duke u ngritur mbi pasionet dhe interesat e vogla, siç u ngritën burra e gra të mençur 79 vjet më parë, për të zgjidhur së bashku hallet e problemet që ka sot vendi.

Shqipërisë i duhet sot më shumë se kurrë mirëkuptimi, bashkëpunimi dhe bashkëqeverisja. Për interesat kombëtare duhet të lëmë mënjanë mosmarrëveshjet, grindjet dhe

mëritë, çdo gjë që bie ndesh dhe dëmton luftën dhe përpjekjet për stabilitet e zhvillim. Ky mesazh vjen nga Konferenca historike e Pezës. Këtë duhet ta ndiejë si nevojë e si detyrë çdo shqiptar, çdo patriot e

çdo forcë patriotike, pavarësisht nga pozicioni dhe orientimi ideologjik që ka. Shqipëria është e të gjithëve dhe të gjithë kanë përgjegjësinë dhe obligimin për ndërtimin dhe përpimin e saj.



STUDIMI

Karakteri atdhetar i luftërave të Skënderbeut, themelues i shtetit të parë kombëtar shqiptar

SKËNDERBEU, STRATEG E DIPLOMAT I MADH

(Vijon nga numri 7-444, korrik 2025)

Prof. ALI HOXHA

....Por ajo që është më e pakonceptueshme për ne, është fakti se karakterin atdhetar të luftës 25-vjeçare të Skënderbeut e ka mohuar edhe personi që aktualisht mban postin e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi, në fjalën e tij në Vatikan, në “Udiencën që mbajti Papa Francesco me rastin e Vitit mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit Skënderbeut me rastin e 550-vjetorit të vdekjes, kur z.G.Ruçi e quajti Skënderbeun “Mbrotjtës i Krishtërit” dhe “Atlet i Krishtit” (“Telegraf”, datë 20 Nëntor 2018, fq.3).

Një vlerësim i tillë antishkencor, i pasaktë për Skënderbeun, nuk mund të shpjegohet ndryshe, përveçse me teorinë e globalizmit dhe me Sistemin shoqëror të Ekonomisë së Tregut ku, sipas tyre, për pak pragmatizës të çastit, u lejuaka që të bëhet tregti me gjithçka: deri edhe me shitjen apo faljen e heronjve të kombit të tjerëve, deri edhe në shtrembërimin e historisë.

Lidhur me nxjerrjen e konkluzioneve dhe interpretimin e ngjarjeve historike, mbi bazën e kronikave të ndryshme për Skënderbeun dhe luftën e tij, Prof. Kristo Frashëri, shkruan:

“Njoftimet kancelareske, kronikale, epistolare dhe memorialistike, janë subjektive... ata nuk vijnë nga një dorë e vetme..., por nga fronte të ndryshme të frymëzuara nga interesa të veçanta, sidoqoftë të pavarura njëri nga tjetri, madje në shumë raste, nga fronte kundërshtarë midis tyre, disa tepër miqësore dhe disa tepër armiqësore ndaj Shqipërisë, ndaj luftës së shqiptarëve dhe ndaj politikës së Skënderbeut. Kështu, për shembull, letrat e papëve, sidomos ato të Kalikst III drejtuar Skënderbeut, janë të gjitha me notë panegjirike. Papët e ngrenë lartë heroin shqiptar, e nxitin ta vazhdojë me vendosmëri luftën kundër sulltanit për mbrojtjen e krishterimit dhe nuk ngurojnë ta quajnë “athlet të Krishtit” (Athleta Christi) – atlet në kuptimin e luftëtarit të madh që mbron një çështje fisnike. Në bazë të këtyre letrave jo pak historianë e kanë vlerësuar Skënderbeun si një kapiten që luftoi për mbrojtjen e krishterimit. Përkundrazi, Republika e Venedikut nuk e cilëson asnjëherë përleshjen shqiptaro-turke si luftë fetare...” (Kristo Frashëri “Marin Barleti panegjirik, fjalimet e heronjve të trilluara”, te “Gazeta Shqiptare” dt. 17 shkurt 2012, f. 20-21).

Në këtë këndvështrim, nisur nga fakti se lufta çlirimtare dhe mbrojtëse e popullit shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut ka penguar, njëherësh, edhe kalimin e ushtrive osmane përtej Adriatikut, në Itali etj., kurrsesi nuk duhet të spekulohet me keqinterpretime subjektivistike të tilla, që për hir

• *Historiani i mirënjohur Prof. Dr. Kristo Frashëri, në veprën e vet “Skënderbeu, jeta dhe vepra” ka saktësuar se, “Skënderbeu nuk zhvilloi luftëra pushtuese, nuk shtypi popuj të ndryshëm dhe nuk krijoi perandori botërore. Ai luftoi me tërë pasionin e pafund dhe me tërë gjeninë e jashtëzakonshme për të mbrojtur atdheun e vet dhe në interes të popullit të vet, mbretërinë e lirisë, për të mbrojtur këtë mbretëri jo vetëm nga armiqtë e Lindjes, por edhe nga grabitësit dinakë të Perëndimit”*



të interesave pragmatiste të çastit, të arrihet deri aty sa t'i ndryshohet edhe karakteri atdhetar i luftërave të popullit shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut duke u dhënë atyre karakter fetar, sikur gjoja ata paskan pas prioritet mbrojtjen e krishterimit.

Lidhur me sa më sipër, theksojmë se deri më sot, pas më shumë se pesë shekuj nga vdekja e Skënderbeut, nuk është gjetur asnjë dokument historik që të flasë për Skënderbeun dhe ku ai të jetë shprehur me gojën e vet se ai ka qenë “mbrojtës i krishterimit”. E shprehur më qartë, nuk gjendet asnjë pohim që Skënderbeu të ketë pranuar se ai ka luftuar për të mbrojtur krishterimin.

Në këtë aspekt, në favor të mendimit tonë na vjen në ndihmë një dokument autentik i kohës së Skënderbeut, i panjohur deri më tani nga historiografia, por i zbuluar para pak kohësh nga historiani Oliver Yens Schmitt. Ai mbi bazën e atij dokumenti, si në veprën e vet kushtuar Skënderbeut, ashtu edhe në intervistën e tij, dhënë publicistit Fatos Lubonja para pak kohësh, ka konkluduar se “lufta e tij (e Skënderbeut-A.H) kundër Sulltanit s'ishte gjë tjetër veçse hakmarrje personale ndaj vrasjes së të atit”, e thënë ndryshe ai pohon se Lufta e Skënderbeut nuk ka pas karakter fetar, me të cilin jemi dakort. Ndërsa lidhur me pjesën e dytë të mendimit të tij “...për hakmarrje personale ...” mendojmë krejt ndryshe nga Schmitt-i. Për të qenë i saktë dhe me qëllim që lexuesit të nxjerrë kon-

kluzionet e veta objektive, po citojmë këtu disa fragmente nga intervista e Schmitt-it:

“Para së gjithash, nuk kemi pasur asnjë dokument mbi motivet personale të Skënderbeut, që, sikurse e kam theksuar që në fillim, nuk i japin, megjithatë, një shpjegim motivesh kryengritjes ... Në fakt dokumenti në fjalë na jep informacion mbi politikën italiane dhe na përshkruan audiencën e ambasadorit të Skënderbeut në Romë. Skënderbeu quhet në këtë kontekst një “infide” (i pafe) (e thënë ndryshe, Skënderbeu konsiderohet mysliman-A.H.), një e dhënë kjo që u korrigjua nga i njëjti ambasador disa ditë më vonë në një raport të dytë, që e plotësoi të parin ...

Për të gjykuar vlerën e burimit, duhet pasur parasysh edhe situata politike e atij momenti: Kostandinopoli kishte rënë disa muaj më parë dhe Papa Nikolla V po përpiqej dëshpërimisht të organizonte rezistencën kundër përparimit Osman. Në këtë moment, një ambasador nga Shqipëria kërkon ndihmë dhe thekson se zotëria i tij nuk po lufton për fenë e krishterë, por për “odio privato”. Thjesht, nuk ka arsye pse diplomatët milanezë të kenë sajuar një histori të tillë. Do të kishte qenë shumë më e lehtë që ata të kishin raportuar për një princ ballkanas që po kërkonte ndihmë në një luftë fetare kundër Perandorisë Osmane myslimane, argument ky që do t'u vinte shumë për shtat edhe ideve politike të papës dhe klimës politike në Italinë e asaj kohe. Ambasa-

dorët e Skënderbeut duhet ta kenë kuptuar se pozicioni i tij ishte disi i pavolitivshëm, sepse papa sigurisht do të ishte më i gatshëm të mbështeste një princ të krishterë që paraqiste veten si kampion të krishtërimit kundër islamit, sesa një fisnik që ishte përfshirë në një konflikt personal me sulltanin dhe ambasadorët e të cilit theksonin se feja nuk luante ndonjë rol në këtë ndeshje. Nuk është për t'u habitur që Skënderbeu ndërroi shumë shpejt strategji dhe u përpoq të sigurojë ndihmë si kampion i një lufte fetare, ide kjo që u zhvillua vite më vonë nga Papa Kaliksi III. Prandaj mendoj se një analizë e dokumentit dhe e kontekstit të tij shpie në përfundimin se ambasadorët milanezë thjesht kanë raportuar çfarë dëgjuan nga ambasadori i Skënderbeut. Ata s'kishin pse ta ndryshonin parashtrimin e tij që ishte mjaft i informuar edhe për sa i përket strategjisë detare të Mehmetit. Dhe s'është se ata kanë përçuar thashetheme, sepse kanë qenë vetë dëshmitarë të audiencës”. (Oliver Yens Schmitt: Lufta e Skënderbeut, hakmarrje personale”, “Panorama”, e hënë 08 tetor 2012, fq.18).

Faktet që mësojmë nga dokumenti i lartëpërmendur, se në raportin diplomatik të ambasadorëve italianë dërguar Selisë së Shenjtë, Skënderbeu e quajnë “infide” (të pafe) d.m.th. musliman, sepse çdo jo të krishterë, njerëzit e besimeve të tjera, Selia e Shenjtë i konsideronte “të pafe” (infide), si edhe fakti se komenti që bën vet Oliver Yens Schmitt, kur pohon se “një ambasador nga Shqipëria kërkon ndihmë dhe thekson se zotëria i tij (d.m.th. Skënderbeu-A.H) nuk po lufton për fenë e krishterë ...” është një argument autentik dhe tepër bindës që vërteton se lufta e Skënderbeut kundër Sulltanit nuk ka pas asnjë karakter fetar por thjesht patriotik. Ndërsa lidhur me interpretimin e Schmitt-it, se Skënderbeu paska luftuar kundër Sulltanit për “odio privato” për hakmarrje ndaj vrasjes së të atit” (“Odio privato” mund të përkthehet si hakmarrje” – sqaron Schmitt, po aty, fq.19), e sqarojmë historianin gjerman Schmitt se në konceptin shqiptar mbrojtja e të drejtave dhe e hakut dhe marrja e gjakut për babanë dhe prindërit e vëllezërit etj, nuk është jashtë patriotizmit, por, bile, pikërisht këtu fillon patriotizmi. Theksojmë se fjala “atdhe” (term ky, sipas prof.E.Çabejt, i krijuar nga F.Konica) në gjuhën shqipe vjen nga fjalët “dheu

vijon në faqen 11

STUDIMI

Karakteri atdhetar i luftërave të Skënderbeut, themelues i shtetit të parë kombëtar shqiptar

SKËNDERBEU, STRATEG E DIPLOMAT I MADH

vijon nga faqja 10

i atit, i babës”, kurse fjala “mëmëdhe” që kanë pas përdorur rilindasit shqiptarë, vjen nga fjala: “dheu i mëmës, i nënës” (“Mëmëdhe quhet toka, ku më ka rënë koka”, – ka shkruar A.Z.Çajupi). Në këtë këndvështrim theksojmë se atdheu e atdhedashuria fillojnë, së pari, nga babai e nëna, nga shtëpia e lagjja dhe pastaj më gjërë, atdhe quhet e gjithë sipërfaqja e tokës deri në piramidën e kufirit të shtetit amtar. Prandaj një njëri që nuk lufton për të mbrojtur të drejtat e prindërve të vet, ai kurrësi nuk mund të mbrojë as atdheun dhe as të tjerët; së pari, njeriu duhet të jetë nationalist në kuptimin patriot, pastaj internacionalist. Për pasojë, mendimi i Schmitt-it se lufta e Skënderbeut kundër Perandorisë Osmane qenka bërë vetëm për “odio privato” (hakmarrje personale), është tepër subjektiv, alla Schmitt-çe.

Historiani i mirënjohur i ditëve tona, prof. Dr. Kristo Frashëri, në veprën e vet “Skënderbeu, jeta dhe vepra” ka saktësuar se, përderisa Skënderbeu luftoi jo vetëm kundër pushtuesve osmanë, por edhe kundër venedikasve, nuk mund të thuhet që ai luftoi si mbrojtës i krishterimit: “Skënderbeu nuk zhvilloi luftëra pushtuese, nuk shtypi popuj të ndryshëm dhe nuk krijoi perandori botërore. Ai luftoi me tërë pasionin e pafund dhe me tërë gjeninë e jashtëzakonshme për të mbrojtur atdheun e vet dhe në interes të popullit të vet, mbretërinë e lirisë, për të mbrojtur këtë mbretëri jo vetëm nga armiqtë e Lindjes, por edhe nga grabitësit dinakë të Perëndimit”. (Kristo Frashëri, “Skënderbeu...”, Tiranë 2002, f. 485).

Në përforsim të mendimit tonë se lufta e Skënderbeut kundër Perandorisë Osmane nuk ka pas karakter fetar për të mbrojtur krishterimin perëndimor dhe se ai nuk ka qenë atlet i Krishtit, siç thonë disa të tjerë, ndihmon edhe pohimi i historianit tjetër të mirënjohur, z. Kasem Biçoku, kur shkruan: “Skënderbeu ka luftuar edhe kundër ushtrive të krishtera, si në vitet 1447-1448 kundër ushtrive venedicane, edhe në vite 1460-1461 kundër trupave të princit të Tarantit në Italinë e Jugut. Në radhët e ushtrisë shqiptare, përkrah njëri-tjetrit, kanë qenë luftëtarët e besimit të krishterë, katolikë e ortodoksë, por edhe të besimit mysliman, siç ka qenë vetë Skënderbeu dhe nipi i tij, Hamzai... Skënderbeu dhe Hamzai kanë pasur deri në fund të jetës emra myslimanë”. (Kasem Biçoku, në “Tema”, 02 mars 2005, f. 9).Pra, argumentet flasin qartë se Skënderbeu ka qenë vetëm “atlet” i atdheut të vet. Por këtu, natyrshëm lind një pyetje: “Ku e mësoi ai këtë politikë dhe harmoni ndërfaqetare?”

Përgjigja e kësaj pyetje, për mendimin tonë, është vetëm kjo: “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, vetëm pasi u bë



Skënderbej, d.m.th. vetëm pasi u njoh me parimet e fesë islame, me Kuranin e shenjtë të myslimanëve dhe pasi e pranoi atë si fe të vetën, kur u njoh me ajete të tilla kuranore si ato ku theksohet ruajtja e identitetit personal e kombëtar, mbrojtja e lirisë dhe e të drejtave të njeriut, jo vetëm si individ, por edhe si komb, si etni, pra të drejtat nacionale të kombeve e kombësive në përgjithësi dhe “nuk ka imponim në fe”, “ndalohet konvertimi në fe i tjetrit me dhunë”, atëherë atij iu zgjua ndjenja kombëtare dhe iu shtua më shumë ndjenja e mallit dhe e dashurisë për atdheun e vet, në momentin e përshtatshëm, kur iu krijuan kushtet për t’u kthyer në atdhe, në kohën e luftës së Sulltanit me J. Huniadin e Hungarisë, në nëntor të vitit 1443, Skënderbeu braktisi të gjithë titujt, ofiqet e nderet që gëzonte në oborrin e Sulltanit, ku ishte një nga gjeneralët më të lavdishëm të Perandorisë osmane dhe erdhi në Shqipëri. Së pari erdhi në Dibrën e vet, i pritur krahëhapur, prej nga ku bashkë me dibranët çliroi Krujën më 28 nëntor 1443 dhe më pas, më 2 mars 1444, organizoi e drejtoi Kuvendin e Lezhës, nga ku me Beslidhjen e Lezhës krijoi dhe sanksionoi shtetin e parë kombëtar shqiptar, duke i bashkuar të gjithë principatat shqiptare në një shtet kombëtar. Me këtë akt, Skënderbeu, vuri në praktikë ajetet kuranore (urdhërat) të tilla që udhëzojnë për çlirimin e vendit, krijimin e shtetit dhe ruajtjen e identitetit kombëtar shqiptar, si individ dhe si komb. Përndryshe, lind pyetja: “Atëherë, përse nuk e krijuan më parë shtetin shqiptar, ashtu siç bëri Skënderbeu në Kuvendin e Lezhës, asnjëri prej feudalëve shqiptarë të krishterë, bashkëkohës të Skënderbeut, siç ishin Aranitët, Balshajt, Dukagjinët, Muza-kajt, Topiajt, Zahariajt, etj., të cilët jo vetëm ishin shumë më të pasur e më të fortë ekonomikisht sesa Skënderbeu e Kastriotët në atë kohë, por ata ishin dhe të lirë këtu, në Shqipëri, secili në pronën e në principatën e vet?!

Përgjigja e kësaj pyetjeje retorike, dihet. Asnjëri prej princave shqiptarë të lartpërmendur të krishterë, as nuk e kishin konceptin e kombit shqiptar, por ata ishin të përçarë e të indoktrinuar nga ideja e globalizmit të krishterë dhe viktimë e politikës së Romës së vjetër “Përça dhe sundo!”

Ata nuk e njihnin fare përmbajtjen e fesë islame e të Kuranit, për të cilën, rilindësi i madh shqiptar, i krishterë, Anton Zako Çajupi, ka përcaktuar: “Ideja myslimane ishte e begatshme, institutive, spirituale.” (“Baba Tomorri”, Alis A. Z. Çajupi, “Rolet e besimeve fetare në Ballkan” (Cituar nga gazeta “Ballkani”, dt. 1 mars 2007, f. 17).

Mbështetur në gjithë sa sipër, kemi argumente të mjaftueshme që të konkludojmë se Skënderbeu është jo vetëm themelues i shtetit të parë kombëtar shqiptar, por njëherësh ai është edhe strategu dhe arkitekti i vënies në jetë të gurit themeltar në zbatimin e harmonisë ndërfaqetare në Shqipëri, ku shqiptarët myslimanë dhe të krishterë kanë bashkëjetuar në harmoni të plotë me njëri-tjetrin jo vetëm në kohë paqeje, por edhe në kohë lufte ata kanë qenë bashkëluftëtarë në të njëjtin front e në të njëjtin llogorë në luftërat mbrojtëse kundër pushtuesve të atdheut tonë, qofshin ato kur vinin nga Lindja Islame, siç ishte ushtria e Perandorisë Osmane, qofshin kur pushtuesit vinin nga Perëndimi i krishterë, si në rastin kur Skënderbeu luftonte kundër ushtrive pushtuese venedicane. Për pasojë kjo traditë e vyer e popullit shqiptar vazhdon të jetojë edhe tani, në ditët tona, nga e cila habitet e gjithë bota.

Përgjigja më e mirë për të gjithë ata që kërkojnë të interpretojnë dhe t’i ndryshojnë karakterin atdhetar të luftës së Skënderbeut është konkluzioni shkencor i prof. Dr. Kristo Frashërit, i cili, në veprën e tij, përcakton: “Lufta çlirimtare një çerek shekullorë me fitoret e saj të mahnitshme, e ndryshme prej kryengritjeve të

mëparshme, është një nga veprat historike të Skënderbeut. Vepra e dytë historike, madje më e madhja për nga vlera historike është krijimi i shtetit me karakter kombëtar dhe jo partikularist. Vepra e tretë historike është, padyshim, kthimi i Shqipërisë në një gardh që pengoi kalimin e ushtrive osmane në Gadishullin Italik, duke mbrojtur qytetërimin evropiano-perëndimor”. (K. Frashëri, “Skënderbeu, jeta dhe vepra”, Tiranë 2002, f. 481, 482, 483). Përfundimisht, logjika e shëndoshë na çon në konkluzionin tonë se lufta e Skënderbeut ka karakter atdhetar. Ai krijoi shtetin e parë kombëtar me Beslidhjen e Lezhës më 02 mars 1444 duke i bashkuar gjithë principatat shqiptare në një shtet kombëtar. Gjithë shqiptarët, muslimanë e të krishterë, nën udhëheqjen e Skënderbeut luftuan së bashku kundër pushtuesve, pa dallim feje, si ndaj atyre osmanë që ishin me shumicë myslimanë, ashtu edhe kundër pushtuesve venedikas që ishin të krishterë. Pikërisht për këto dhe shumë arsye të tjera, dy senatorët amerikanë, që iu drejtuan kongresit për një rezolutë në Kongres për Skënderbeun, e mbyllin kërkesën e tyre me këtë thirrje: “Të ftojme qeverinë e SHBA-së që, në bashkëpunim me partnerët evropianë, ta përshejtojnë integrimin e Shqipërisë dhe të Kosovës së lirë në Bashkimin Evropian, në shenjë mirënjohjeje për kontributin e madh dhe sakrificën e bërë nga Gjergj Kastrioti dhe populli

shqiptar për shpëtimin e Evropës Perëndimore nga pushtimi osman”. (citimi sipas gazetës “tema”, datë 4 nëntor 2005, f. 9).

Sa aktual dhe i dobishëm është Skënderbeu për atdheun tonë, edhe tani, 550 vjet pas vdekjes së tij! Në këtë aspekt flet mjaft qartë intervista e ish-ambasadorit amerikan të SHBA-së në Shqipëri, z. Ëithers botuar në gazetën “Sot”, datë 19 janar 2012, f. 2, kur flet për zhvillimet politike aktuale në Shqipëri: “... Shqipëria ka një nga shembujt më të mëdhenj të udhëheqjes me gjithë historinë, që është Skënderbeu. Mjafton t’i hedhësh një sy modelit që ai ka lënë, pasi ai ishte një udhëheqës që solli bashkimin në Beslidhjen e Lezhës në vitin 1444. Ai i bashkoi të gjithë palët rivale për interesa kombëtare. Udhëheqësit e sotëm nuk janë bashkues, janë përçarës... Shqipërisë i duhet një Skënderbe sot, më shumë se kurrë ndonjëherë më parë. Por në Shqipërinë e sotme nuk ka Skënderbe dhe mua më vjen keq për një gjë të tillë”.

* Ish-Kryetar i Shoqatës etno-kulturore “Çidhna dhe Kastriotët në mandatin e parë. (Ripunim, referuar në sesionin shkencor në Peshkopi më 25 Nëntor 2018, me rastin e Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit Skënderbeut në 550-vjetorin e vdekjes)

81 VJETORI

Rruga e lavdishme e Brigadave të 20-të, 22-të dhe 23 Sulmuese Partizane

Brigada e XX-të, pjesë e uraganit të fuqishëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare

Më 9 shtator, veteranët e LANÇ dhe pasardhësit e tyre do të jenë shpirtërisht në Protopapë, Maliq, Korçë, Pogradec, Elbasan, Librazhd, Zvezdë, Qafë-Thanë, Përrenjas, Domozdovë, në grykat e Xhyrës dhe kudo ku kanë luftuar e fituar partizanët e Brigadës XX Sulmuese.

Brigada XX u formua në Protopapë, më 9 shtator 1944, prej bashkimit të batalionit të famshëm "Tomorri", me batalionet e tjera që vepronin në këto krahina, si "Reshit Çollaku", "Hakmarrja", "Fuat Babani" dhe "Skënder Çaçi". Asaj iu bashkuan qindra vajza e djem të rinj nga Korça, Skrapari dhe Elbasani, të cilët formuan sëbashku këtë formacion partizan, të njohur për vitalitetin, trimërinë dhe heroizmin e pashoq. 1200 partizanët e Brigadës XX, siç shkruan historia e Luftës, nuk kanë në bilancin e tyre asnjë betejë të humbur.

Vetëm një ditë pas krijimit, më 10 nëntor 1944, partizanët e Brigadës XX hynë në Librazhdin e çliruar dhe një javë më vonë, më 17 nëntor, në Elbasanin e çliruar. Populli i Elbasanit, Li-

brazhdit dhe gjithë krahinave të tyre do t'u jetë mirënjohës përjetë vajzave e djemve të kësaj brigade, të cilët i çliruan ato nga okupatori nazi-fashist dhe bashkëpunëtorët e tyre vendas.

Brigada XX ishte pjesë e uraganit të fuqishëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, e cila çliroi Shqipërinë nga pushtuesit nazi-fashistë dhe tradhëtarët vendas.

Ushtria e partizanëve shqiptarë luftoi denjësisht në krah të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ushtrisë së Kuqe, Ushtrisë së Britanisë së Madhe, të Francës dhe vendeve të tjera të koalicionit antifashist. Ishin partizanët shqiptarë, këta kalorës të çlirimit e të lirisë, që e vendosën Shqipërinë në anën e drejtë të historisë, në krah të forcave antifashiste e çlirimtare.

9 shtatori, është dita të kujtojmë se Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe vlerat antifashiste nuk vjetërohen kurrë. Ato qëndrojnë në themel të lirisë, të përparimit, të kontributit tonë në NATO, për paqen, sigurinë e stabilitetin në rajon e në botë, në themel të rrugëtimit europian të Shqipërisë.

- **Vlerat antifashiste nuk vjetërohen kurrë. Ato qëndrojnë në themel të lirisë, të përparimit, të kontributit tonë në NATO, për paqen, sigurinë e stabilitetin në rajon e në botë, në themel të rrugëtimit europian të Shqipërisë**



Brigada e 22-të Sulmuese dhe luftimet nga Peza në Vishegrad

- **Kujtojmë në këtë 81 vjetor të krijimit të saj ish komisarin e saj, të paharruarin Nimet Ymeri, i cili na ka lënë pas, si një testament të vyer librin e tij "Nga Peza në Vishegrad"**

Më urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSh, më 18 Shtator 1944, në Pezën heroike të komandantit legjendar Myslim Peza, u krijua Brigada 22 Sulmuese partizane e ushtrisë shqiptare. Aty te sheshi i gjelbëruar para shtëpisë së komandantit të Çetës së parë antifashiste në Shqipëri e Europë, Babë Myslimi, ishin të rreshtuar në formacion të rregullt, të ndarë në batalione e kompani, 1127 partizanë.

Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti trim Myslim Peza, përfaqësuesja e Komitetit Qendror të PK Naxhije Duma, përfaqësuesi i ShP të UNÇSh, Kristo Themelko, i cili edhe përshëndeti me këtë rast. Për drejtimin e Brigadës 22 Sulmuese, u caktuan: Komandant i Brigadës, komunisti Sali Verdha. Zëvendëskomandant i Brigadës Shaban Rexha. Komisar i Brigadës, komunisti Tonin Jakova.

Zëvendëskomandant i Brigadës, Sadik Bocaj. Komandant i batalionit të parë, Muharrem Kokomani (i cili pas disa ditësh caktohet komandant i Brigadës 23 Sulmuese partizane). Komisar i batalionit të parë komunisti Shim Kolli. Komandant i batalionit të dytë, Sotir Spiro.



Komisar i batalionit të dytë, Xhevdet Petrela. Komandant i batalionit të tretë, Ymer Hoxha.

Komisar i batalionit të tretë, komunisti Hysen Ballhysa. Komandant i batalionit të katërt u caktua komunisti Nimet Ymeri, i cili në nëntor 1944 caktohet komisar i brigadës 22 Sulmuese, deri në 15 dhjetor 1945. Sadik Bocaj u caktua drejtues i organizatës së partisë të Brigadës 22 S, e cila kishte 75 anëtarë të PK. Iliaz Reka u caktua drejtues i Rinisë të Brigadës 22 Sulmuese.

Për rreth 20 ditë Brigada e 22 Sulmuese zhvilloi luftime në zonën e Tiranës, Kavajës, Peqinit, Durrësit, Shijakut për eliminimin e elementëve kriminalë të Ballit Kombëtar, për forcimin e pushtetit të ri të këshillave nacional-Çlirimtare dhe dorëzimin e pushtetit, komandave të vendit.

Me datën 6 e 7 tetor 1944, Brigada e 22 Sulmuese ishte pozicionuar në fshatin Gropje të Tiranës nga ku mori urdhërin luftarak për marshim për në veri të Shqipërisë, duke kaluar në zonën e malësisë së Krujës, me luftime të ashpra çliron Shpalin, kryeqendrën e bajraktarëve të Mirditës, shpartalloi forcat e reaksionit të Gjon Markagjonit, dhe të Kol Bibë Mirakës. Luftime të ashpra u zhvilluan në Fan, Gëziq, Gjegjan, Kryezi,

Perkulemi me respekt të thellë përpara 21 dëshmorëve të kësaj brigade dhe familjeve të tyre

Lavdi 21 dëshmorëve të Brigadës së XXIII Sulmuese

81 vjet më parë, më 21 shtator 1944, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, në Zall-Mener, u krijua Brigada e 23 Sulmuese Partizane. Kjo brigadë u formua nga batalionet partizane “Dajtit”, “Krujë -Ishëm “ dhe “Mat” te cilët kishin në efektiv të tyre partizanë me pervojë, të kalitur në aksione luftarake kundra nazifashizmit italo - gjerman si dhe tradhtareve te vendit, qe kishin kaluar prova të renda, sakrificash ne lufte, sidomos gjate Operacionit të Dimrit 1943 dhe të Qershorit 1944. Drejtuesit e Shtabit të Brigades ishin: Komandante- Hamit Keçi, Haxhi Seseri, Muharrem Kokomani; Komisarë politikë- Xhavit Qesja, Mërkur Çela; zv/komandant Haki Fejzo, zv/komisar Sejdin Avdia.

Sapo u formua brigada me drejtuesit e saj, u ngarkua me detyren luftarake qe te merrnin pjese ne lufte per Çlirimin e Tiranës, Krujës, Vorës, Fushë- Krujës, Prezes, Milotit, Pukës, Mirditës, Matit, Lezhës e deri ne Shkodër. Ngarkoheshin të goditnin përqëndrimet armike te vendosura ne ato zona dhe do te shkaterronte forcat merceneare, si ato zogisto - balliste, te cilet ishin pro e bashkëpunonin me pushtuesit nazifashistë te perqendruara ne kalatë e Krujes, Prezes e Ishmit.

Luftrat e Brigadës së 23-te sulmuese ishin shumë të suksesshme mbasi pati mbeshtetjen e fortë nga këshillat ANÇ, familjet që i kishin kthyer shtepite baze lufte dhe mbare populli i ketyre zonave. Luftrat u bene nga nje zone ne tjetren dhe arriten deri ne Shkoder.

Në mëngjesin e 29 nentorit 1944 forcat e kesaj brigade pas një lufte të ashpër per clirimin e Shkodres, duke iu bashkuar forcave të brigadav 6-te , 7, 22 dhe 24-t dhe grupeve partizane të atij qyteti - te gjithë bashkë, pasi shporrën pushtuesit dhe bashkëpunëtorët e tyre nga Shodra, u grumbullun perpara Prefektures ku u mbajt ceremonia festive dhe u dha lajmi qe Shkodra u clirua. Clirimi i Shkodres shenonte edhe clirimin e gjithë Shqiperise nga pushtuesit nazifashiste.

Kjo qe nje ngjarje me rendesi te madhe historike dhe u perhap ne te gjithë vendin.

Në këtë 81 vjetor, duke perkujtuar rrugën e lavdishme luftarake te Brigades 23-te Sulmuese, u shprehim mirenjohje të gjithë atyre partizanëve që bënëin pjesë në këtë brigadë dhe të gjithë familjeve të tyre dhe shtëpive baze te LANC, si dhe Keshillave Antifashiste.

Perkulemi me respekt të thellë përpara 21 dëshmorëve të kësaj brigade dhe familjeve të tyre.



21 DËSHMORËT E BRIGADËS XXIII S

Ne Krujë, te kthesa e rrugës qe shkon per ne Qafshatame, per te perjetesuar formimin e Brigades 23 S, luftën e saj heroike kundër armiqve si dhe dëshmorët e saj, eshte ngritur lapidari ku jane skalitur emrat e të gjithë dëshmoreve të saj si me poshtë:

1. Abaz Veseli
2. Adem Gjeli
3. Ali Metra
4. Avdi Kazani
5. Riza Beka
6. Bakushe Visha
7. Besim Beja
8. Gani Guxhiqi
9. Islam Shehi
10. Luigj Kurti
11. Njazi Meka

12. Llesh Spaçi
13. Mustafa Dervishi
14. Mustafa Mezini
15. Ibrahim Liçi
16. Ramazan Zambaku
17. Rexhep Shira
18. Shaban Lika
19. Turabi Dura
20. Vath Bushi
21. Vesel Brama

Brigada e 22-të Sulmuese dhe luftimet nga Peza në Vishegrad

Vijon nga faqja 12

ku ra heroikisht pionieri 14 vjeçar Met Hasa, partizani Rexhep Kodra (Fortuzi), si dhe u plagosën partizanët Fatime Pullazi, Sherbet Karulli, Shkurt Pajona, Etem Kalaja, Zydi Mustafa, Haxhi Grori, Asllan Istrefi, Stavri Goreja. Luftime të ashpra u zhvilluan gjatë muajit nëntor 1944, në zonën e Mirditës e të Pukës, dhe më 21 nëntor Puka çlirohet. Pas kësaj, Brigada e 22 S, nisët drejt Shkodrës, ku ishin përqëndruar edhe brigadat e 6-të dhe e 7-të.

Me luftime të ashpra në datat 26-27-28 nëntor dhe në mëngjesin e datës 29 Nëntor 1944 Shkodra dhe e gjithë Shqipëria ishte e çliruar plotësisht nga pushtuesi nazistë gjermanë.

Në orën 10.00 paraditen e 29 Nëntorit në Shkodrën e çliruar ngrihet flamuri i lirisë, ku zëvendësoimisari i batalionit Irfan Çelkupa mban një fjalim emocionues para popullit shkodran e partizanëve.

Pas 3-4 ditësh pushimi në Shkodër, Brigada e 22 Sulmuese, nisët me urdhër të komandës e ShP,

për të kaluar kufijtë shtetërorë në ndihmë të popujve të Malit të Zi dhe Bosnjes.

Me luftime të ashpra forcat partizane kalojnë kufirin shtetëror, dhe në Deçiq bien heroikisht partizanët trima dëshmorë të atdheut Xhemal Zanalui, Demir Milaqi, Rahman Myrta, mitralieri trim Qazim Alimehmeti, dhe më 6 dhjetor 1944 u çlirua qyteti i Tuzit.

Në këto luftime ranë në fushën e betejës shumë partizanë dhe gjermanët pësuan humbje të rënda. Pas çlirimit të Podgoricës brigada e 22 S, nisët për luftime drejt Bosnjes jugore në mes të një dimri të egër, me dëborë, dhe acar.

Nga 31 dhjetori '44 deri më 5 janar 1945 arrijnë në afërsi të Suhagorës; çlirojnë Goleshin dhe Plavien, dhe pas pak ditësh çlirojnë Vishegradin.

Ranë heroikisht 12 partizanë, Zyber Jancari, Naum Shamia, Ramazan Ismil Gjuzi, Ramazan Dervish Habili, Thoma Koli Filipi, Haxhi Selim Maloku, Ibrahim Myrteza Brahja, Ferhat Haxhi Berberi, Riza Pëllumb Leshteni, Sulejman Rexhep Rexha, Nebi Ramazan Hoxha,

Rustem Ibrahim Dervishi. Me çlirimin e Vishegradit, Brigada e 22 S, kthehet për në Kosovë dhe më 12 mars '45 arrijnë në Mitrovicë. Me 3 mars përqëndrohet në qytetin e Vuçiternit. Më 4 prill '45 bëhet ceremonia e varrimit e Rexhep Zunës, komandant i brigadës 22 S, i cili vdiq në spitalin e Mitrovicës dhe Neshat Hysi caktohet komandant i brigadës. Për aq sa ishte në Kosovë brigada ndihmoi në stabilizimin e situatës atje.

Në ditët e para të qershorit 1945 brigada kaloi në tokat shqiptare të Maqedonisë në ndihmë të këtyre krahinave dhe për pastrimin e bandave kriminale të Adem Ali Basharit, Gjon Markagjonit e Pashuk Bibës. Më 7 dhjetor '45 mbërrin në Elbasan e përqëndrohet në kazemat e Krastës. Këtu përfundoi misioni i saj heroik. Nga efektivit prej 1400 partizanësh, dhanë jetën 107 partizanë. Brigada përshkroi një rrugë prej 3500 kilometrash.

Kujtojmë mes të tjerash në këtë rast ish komisarin e saj të paharruarin Nimet Ymeri, i cili na ka lënë pas, si një testament të vyer librin e tij “Nga Peza në Vishegrad”.

DOSSIER

Si u mposht ekspedita fashiste e Xhafer Balit nga malësorët trima të Reç e Dardhës

84 vjet më parë - Qëndresa heroike në Kodër të Kacës



Nga Dine KACA

Kur na ndajnë vetëm pak ditë nga 84-vjetori i qëndresës heroike të “tigrave” të Reç e Dardhës (siç i njih edhe kënga popullore) në Kodër të Kacës kundër ekspeditës fashiste të Xhafer Balit, nga arkivi i gazetës “VETERANI”, nxorëm dhe vendosëm të botojmë artikullin e shkruar vite më parë nga studiuesi i mirënjohur Dine Kaca – një nga personalitetet dibrane me rrezatim kombëtar. Kjo edhe si homazh në nderim të jetës dhe veprës së këtij bashkëpunëtori, ndër më produktivët e gazetës sonë, i cili humbi betejën me jetën përballë flamës Covid-19, pesë vjet më parë, duke na lënë një trashëgimi fundamentale nga studimet e tij historike disavjeçare....

Halil RAMA –

Kryeredaktor i gazetës “VETERANI”

BESËLIDHJA E QËNDRESËS ANTIFASHISTE

Pas disfatës në Dibër të Madhe me forcat kryengritëse të drejtuar nga luftëtari trim e i paepur Haxhi Lleshi, ajo që e shqetësonte më shumë fashizmin do të qe se dibranët mbanin armë të fshehura dhe se një ditë Dibra, do të mund të ngrihej në luftë të armatosur kundër fashistëve dhe bashkëpunorëve të tyre, deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë. Prandaj në vazhdim të masave ndëshkimore, fashizmi do të organizonte ekspedita operacionale në të gjithë Dibrën për dorëzimin nga dibranët të armëve të fshehta dhe municioneve. Kjo u diktua edhe nga qëndrimi që mbajtën shqiptarët në luftë kundër agresionit fashist që ndërromori Italia ndaj popullit grek në 1940-tën.

Ekspeditat kryen operacione në të gjithë krahinat e Dibrës, ndërsa krahinat Reç e Dardhë, qenë lënë për në fund. Gjatë operacioneve, pati rezistencë të fortë, por gjithësesi ato kishin mundur të grumbullonin një sasi të vogël armësh e municionesh.

Në strategjinë e taktikën fashiste, jo pa qëllim ishin lënë për në fund krahinat Dardhë e Reç. Kjo për faktin historik se ato njiheshin si krahina të lidhura shumë ngushtësisht njëra me tjetrën dhe se bijtë e tyre qenë shquar për trimëri e atdhetarizëm. Ata patën dhënë prova të forta kundër pushtuesve, çka e vështirësonte së tepërmi çarmatimin e tyre. E kjo qe bërë mos represioni do të ndikonte që edhe Reç e Dardhë t'i nënshtroheshin këtij operacioni. Fashizmi nuk kishte nevojë për armë, por donte të shuante çdo vatrë e lidhje patriotike që përbënin rrezik për të.

- **Krahinat Dardhë e Reç të Dibrës, gjithmonë kanë vepruar me organizmat e zgjedhura nga vet populli. Ato kishin detyra e të drejta komplekse, për të gjithë jetën e krahinës, ku më kryesorja ishte ajo e mbrojtjes së atdheut....**
- **Dibranët në përgjithësi, demonstruan qartazi, se qenë përdere patriotë, u shfaq lart ndergjegjia kombëtare, se dibranët ishin të gatshëm edhe për beteja te tjera....**



Termi “çarmatosje” tingëllonte shumë rëndë në veshin, psikologjinë dhe mentalitetin e popullit të Reç e Dardhës. Nëse do të ndodhte kjo, do të ishte për ta poshtërim i madh, do t'a quanin veten se nuk ishin më askushi. Edhe para fashizmit, pushtues të tjerë që nga turqit osmanë, bullgarë, austro-hungarez e të tjerë, apo regjime antipopullore, nuk kanë mundur as t'i çarmatosin dhe as t'i nënshtrojnë. Arma në duart e tyre ishte gjithshka. Historikisht, luftat e njëpasnjëshme, ua kishin imponuar që ta konsideronin armën pjesë të jetës, të qënies së tyre. Me armën ata patën lidhur jetën e tyre, mbronin familjen, dinjitetin, nderin, lirinë, atdheun për të cilin nuk kursenin as jetën.

Ata kishin një përvojë shumë të pasur, të trashëguar brez pas brezi, pavarësisht se në të gjitha luftat e betejat me armiqtë pushtues, në raportin e forcave, ata kishin qenë në pakicë, por shpirti liri-dashës e luftarak, atdhetarizmi, optimizmi dhe vendosmëria i bënë superiorë. Kurdoherë fitorja ishte në anën e tyre. Edhe ky ishte një faktor që i bënte këto dy krahina të ishin të vendosura në qëndresë me ekspeditën ushtarake fashiste për çarmatimin dhe e kishin të sigurtë fitoren ndaj saj.

Krahinat Dardhë e Reç të Dibrës, gjithmonë kanë vepruar me organizmat e zgjedhura nga vet populli. Ato kishin detyra e të drejta komplekse, për të gjithë jetën e krahinës, ku më kryesorja ishte ajo e mbrojtjes së atdheut. Kështu, krahina e Dardhës drejtohej nga të “15-tët e dheut” ose siç mund të quhet një “Kuvend – Parmament” i Dardhës me përfaqësues të denjë me integritet, si: Hysen Ndreu, Hysni Kaca, Hysen Bara, Hysen Çera, Misim Ahmeti (Cerpja), Rahman Rasha, Ahmet Kazi, Vesel Sula, Muharrem Hoxha, Taf Shira, Ali Bajram Ndreu, Sul Cani, Met Kaca, Selim Hysa e Can Gjoka. Më vonë për arsye vdekje, janë zgjedhur të tjerë nga populli si, Xhetan Hakiku, Haziz Poleshi, Mehdi Kaca e Sadik Çera. Një organizëm të ngjashëm drejtimi me Dardhën kishte edhe krahina e Reçit, por jo me kuvend, por me pleq.

Të dyja këto organizma të këtyre krahinave kishin përcaktuar pikat e besëlidhjes të qëndresës antifashiste. Debatimi dhe marrja e vendimit qe bërë në bazë fisi, fshati e krahine me moton “besa-besë”.

Përfundimisht u vendos:

Së pari, në përballjen me ekspeditën u caktua nga një burrë për shtëpi, (aty ku kishte disa burra në disa shtëpi, të vinin dy edhe tre), kryesisht të moshuar, të sprovuar në lufta dhe ky organizëm ishte konsideruar si skalion i parë. Burrat e tjerë dhe moshat e reja, do të qëndronin të gatshëm në rast nevojë si skalion i dytë për luftë të armatosur frontale.

Së dyti pjesmarrësit e të dy krahinave do të grumbulloheshin në mënyrë të organizuar në Kodër të Kacës të Dardhës.

Së treti, asnjë armë nuk do t'i dorëzohej pushtuesit. Kur pushtuesit do të kërkonin dorëzimin e armëve, fillimisht pjesmarrësit do të heshtnin deri në kulmin e durimit.

Së katërti, në momentin që do të shanin apo do të përdornin forcën, do të hidheshin në sulm deri trup me trup për ta çarmatosur të gjithë ekspeditën. Nëse do të qëllonin me armë e do të kërkonin forca ushtarake shtesë për të shtypur popullin me dhunë, do të nxirreshin armët dhe do të ngriheshin në “shtatë e shtatëdhjetë” në luftë kundër pushtuesit fashist.

Kjo përgaditje nuk u bë brenda një apo dy e tre ditësh. Jo. Kishte kohë që punohej për këtë. Unë dhe moshatarët e mij i kujtojmë me hollësi, se si baballarët dhe gjyshërit tanë na patën përgatitur për çdo lloj situatë. Ata kanë një meritë të veçantë ndaj brezit tonë.

Armët dhe municionet e fshehta, ashtu siç dinin vetë t'i përdornin, na i kishin mësuar edhe ne të rinjtë. Jo vetëm si mbahet, si përdoret, si merret vija e shënimit për të godit me plumbin e parë në shenjë, por edhe si mund të ndeshesh trup me trup dhe t'i marrish edhe armën armikut, e shumë gjëra të tjera. Kishte gati dy muaji që Reç e Dardhë bënë përgatitje. Sa do që kalojnë vitet, edhe pse tani jemi në ekstremet e moshës, i kujtoj me nostalgji, me respekt, me shumë dashuri dhe u jemi mirënjohës atyre burrave trima, atyre “tigrave” të asaj kohe. Ata na brumosën me virtytet më të larta dhe ndjenjën e dashurisë për atdheun tonë, Shqipërinë.

vijon në faqen 15

DOSSIER

8 Shtator 1941 – Qëndresa e “tigrave” të Reç e Dardhës për të mos dorëzuar armët



Në foto DINE KACA

Vijon nga faqja 14

Sapo zbardhi drita, fshatarët e fshatrave të largëta të Reçit filluan lëvizjen drejt Kodrës së Kacës të Dardhës. Të parët ishin burrat e fisit Doda në Tejmalle, në kufi me Arnin e Kukësit, të fiseve Laçi, Gjurma, Poga ne Gjurre-Rec; Lusha, Leka, Sinani, Laçi, Doda, Toshi, Lala e Troci në Ndërshenë e Hurdhë - Reç; Shehu, Cara, Prençi e Hasani në Bardhaj - Reç; Troci, Leka, Tanushi, Lala, Meçi, Murati, Elezi e Uklala në Thark e Zall-Reç; Troci, Kuqi, Doda, Peca, Shoti, Çajka, Prençi, Halili dhe Hasani Drax-Reç; Koka, Marku, Mziu, Vladi, Tafa, Lami, Skeja, Sufa, Hysenaj, Bardholi e Shehu në Kraj-Reç.

Aty nga ora 9.00 rreshtat e burrave të krahinës së Reçit u futën në teritorin e Dardhës, ne tre drejtime kryesore: Lashkizë – Tartaj –Kodër e Kacës, Soricë – Merskanë - Tartaj - Kodër e Kacës dhe Shënllëshën – Zall Dardhë – Lugje - Kodër e Kacës. Në këtë kohë krahina e Dardhës ishte gati në pritje të vëllezërve reçjanë, me të cilët u bashkuan, sipas fiseve: Çerpja, Hysa, Rasha, Topuzi, Ndreu, Cani, Poleshi e Hoxha në Lashkizë, Soricë e Merskanë; Kaca, Çera, Xhediku, Çajkri, Luca, Bara, Xhaferi, Demiri, Braka në Tartaj e Nezhej; Kazia, Cani, Sula, Murati, Ndreu, Hoxha, Shira, Rama, Çepja, Hysa, Bara, Gjoka, Dervishi, Pira, Luca, Cala, Topuzi e Lushi në Shënllëshën, Zall Dardhë e Lugje të Dardhës.

Kodra e Kacës ku do të mbledheshin “Tigrat e Maleve” të Reç e Dardhës ishte vendi më strategjik. Njerëzit që patën mbetur nëpër shtëpia, ishin në ankth. Ata qëndronin në gadishmëri. Shumë domethënës ishte momenti kur takohen reçjanët me dardhianët, shtrëngimi i duarve, besa e lidhur, vendimi i marrë, i bënte ata të ecnin me kokën lart pa iu dridhur çerpiku.

Burrat e këtyre anëve kur shkonin në kuvende për beteja lufte me armikun, visheshin me rrobat më të mira. Nën, gratë e motrat e tyre i kishin përgatitur me kostumet më të bukura kombëtare të krahinës. Që nga opingat me gjalma të bardha, çorape të qëndisur, tyrqe me gajtana, këmbisha të bardha me mëngë të lëshuara, breza leshi të thurur me larmi ngjyrash, xhamadana të llojeve të ndryshme e me gajtana, plise të bardha (qeleshe të bardhë) e deri tek sumullat e xhamadanave e cistekët e sahateve që xixëllonin nga rrezet e diellit e që krijonin shije artistike mahnitëse dhe të dukej sikur ata ishin me të vërtetë krushqit e një dasme madhësh-tore.

Me këtë veshje karakteristike të krahinave i jepnin të kuptonte ekspeditës fashiste dhe Major Balit që e komandonte atë se: “ne jemi një popull me kulturë, kemi personalitetin e dinjitetin tonë, se dijmë të vishemi, dijmë të flasim, dijmë shumë mirë të njohim mikun dhe armikun...”, dijmë të luftojmë e të mbrohemi...se kemi ardhë këtu me një mendim e betim të përbashket: “O fitojmë dhe nuk dorëzojmë asnjë armë, O vdesim të gjithë”. Vetëm një gjë na mungon sot: Ajo që kërkoni ju,“Maliheri”. Atë e kemi lënë në shtëpi dhe kurrë s’keni për ta marrë. Paçka se sot jemi të paarmatosur, ne dijmë të luftojmë edhe pa armë! Provojeni...”

Kodra e Kacës, në ora 10:00, që mbushur me rreth 700 trima “Tigra”, ulur pranë e pranë njeri – tjetrit. Në sytë e tyre lexohej karakteri burrëror, vendosmëria, besimi në fitoren e përballjes që pritej të ndodhte nga çasti në çast. Ekspedita ushtarake ishte dislokuar aty afër. Në momentin para se të fillonte të fliste, komandanti fashist Xhaferi Bali dha sinjal dhe ekspedita krijoi një kordon në formë rrethi, 15 metra larg nga vendi ku ishin ulur malësorët trima. Të gjithë vëzhgonin mënyrën e lëvizjes të ekspeditës dhe armatimet. Fiksonin në detaje se si mund t’i kapnin e t’u merrnin armët kur do të bëhej përleshja, vënin se ku kishte gurë, gardhiqe për të marrë hunjtë e mjete të tjera të forta për të sulmuar ekspeditën.

Më pas edhe vetë komandanti i saj me suitën që e shoqëronte u pozicionua përballë gjigandëve. Ma-



jor Bali që befasuar kur të gjithë trimat e Dardhës e të Reçit gozhduan sytë tek ai dhe shoqëruesit e tij. Ai që vënë përballë një force shkatërruese të papërbal-lueshme.

Gjithesesi e kishte filluar fjalën duke ju dridhur zëri: “fashizmi është garantuesi i mbrojtjes tuaj, i qetë-sisë populke, i së ardhmes, prandaj nuk keni nevojë të mbani armë e municione. Ato do t’i dorëzoni ...”. Për disa minuta ai u përpoq t’iu mbushte mendjen dhe u drejtohej: “Hë, kush do të flasë?” Asnjë nuk e kishte marrë fjalën! Ata flisnin me gjuhën e trupit. Syte nuk ia kishin ndarë Xhaferi Balit. Me këtë qëndrim, ata i thonin: “mos u gënje se do t’ju dorëzojmë armë, mos guxo të përdorësh forcën”.

Heshtje! Xhaferi Bali kishte filluar të acarohet, rri-ti disi tonet e të folurit urdhërues ushtarak. Ndërsa malësorëve po u ziente gjaku e urretja nga brenda. Ata po e lexonin njëri - tjetrin në sy.

I pari ishte ngritur Can Gjoka nga Dardha: “Or zot-ni, ti na kërkon të dorëzojmë armët, por s’i t’ia bëjmë?! Ne nuk kemi armë dhe aty ku nuk ka s’ke se çfarë merr”.

Unë. – kish thënë Bali – nuk kam ardhë këtu të dëg-joj fjalë boshe, por dua të dorëzoni armët”!

Pastaj e kish marrë fjalën Sadik Doda nga Reçi: “Ti more zotni, na kërkon armë? Por arma ka qenë shpirti e jeta jonë. Me ato kemi luftuar pushtuesit, por për fat të keq nuk i kemi. Po t’i kishim në dorë në këtë moment edhe ne do t’i kishim “dhënë” e me kaq ta mbyllim”.

Xhaferi Bali, i acaruar u kishte thënë malësorëve se: “nuk largohemi prej këtej pa grumbulluar armët, mos hezitoni t’i dorëzoni ato, për ndryshe do të keni pasojat”

U ngrit Hysni Kaca nga Dardha: “O zotni major! Siç na shikon gjithë këta burra kemi ardhë këtu. Të gjithë sa jemi, kemi qenë të armatosur. Kemi luftuar kundër pushtuesve turq, serb, bullgarë, kundra nemces etj. Sa për ta ditur, edhe unë kam patur pushkë. Atë ma kishte dhuruar Elez Isufi në luftë. Ato i kemi dorëzuar. Ju jeni shqiptar e duhet të na kuptoni, paçka se ti je komandant i kesaj ushtrie të armatosur që na ke rrethuar. Mirë është të mos e zgjasim me këtë punë se s’kemi çfarë të të japim...”

Xhaferi Bali që e kishte pa se nuk po bënin efekt kërcënimet, përdori një taktikë tjetër. Nga Çidhna pati marrë tre burra nën vërejtje, gjoja se ato kishin nge-lur pa dorëzuar armët. Që të friksonte burrat e Reçit dhe të Dardhës dha sinjalin që të përdorej dhunë ndaj njerit prej tyre dhe të arrestohej Medi Kaca. Në kohën që u bënë gati dhe filluan të zbatonin urdhërin e tij, ky që momenti i duhur për t’i vënë shkëndinë benzin-atës dhe si si vetëtimat u degjua zëri i Mahmut Laçit nga Gjurr-Reçi: “Burra, me dor t’i kapim?!”. Thirrja e tij ishte pasuar nga Rrahman Rasha e Halim Lika (Cani), Musa Gjoka e Vesel Sula, Riza Poleshi e Riza Ndreu, Dali Leka e Dali Lami, Bajram Lusha e Ahmet Cani, Selman Halili e Mer Troci, Isuf Dervishi e Halim Kaca i Kodres, etj.

Të 700 burrat, si vetëtimat qenë vërsulur me thirr-jen: “besa-bese-burra-aaa ha ha ha”, oshtiu zëri i tyre i fuqishëm, duke rrokur ç’fare gjetën përpara: gurë, hunj, fturçe, sopata e mjete të tjera të forta.

Në ndihmë të menjëhershme u erdhën burrat e tjerë të shtepive të fisit Kaca që ishin shumë afër dhe të fisit Xhediku e Çera, që u ofronin mjete të forta. Si tigra u lëshuan mbi major Xhaferi Balin, grupin që e shoqëronte dhe ekspeditën. Ai e pa se njeri i gjallë nuk do shpëtonte nga kjo forcë shpërthyes. I dha urdhër ekspeditës që të mos shkrehej asnjë armë e vetme dhe të tërhiqeshin me shpejtësi të rufeshme për të dalë nga flakët e zjarrit përvëlues.

Të goditur nga breshëritë e mjeteve të forta e deri në përleshje trup me trup, Xhaferi Bali, i mbrojtur nga shoqëruesit dhe tërë ekspedita, u larguan si mos më keq. Trimat i ndoqën fashistët deri sa kaluan teritorin e krahinës së Dardhës. Edhe nëpër fshatin Mustafaj të krahinës së Çidhnës nuk e ndalën vrullin. Ekspedita kaloi Drinin dhe mori rrugën për në Peshkopi.

Pas fitores ndaj Xhaferi Balit u vendos itifaku: Të

evitohen grindjet dhe hasmëritë

Pas qëndresës, të gjithë malësorët u kthyen përsëri në vendin ku ishte zhvilluar përleshja. Aty u përcaktuan detyra të reja për çdo situatë të papritur. Unanimisht u vendos itifaku: Të evitohen grindjet dhe hasmëritë. Të 15-të e Dardhës dhe Pleqtë e Reçit, do të siguronin informacionin e nevojshëm për përshkallëzimin e ve-primeve të dhunës që mund të ndërmerre pushtuesi ndaj dy krahinave si hakmarrje, ndaj kërkohej të vi-heshin menjëherë në dijeni që të organizoheshin sa më shpejt kundër tij.

Edhe njëherë ishte theksuar se duhej të ishin të gjithë të bashkuar, në një mendje, të vendosur se edhe me këtë pushtues do të ishin në luftë të vazhdueshme deri sa ta shpornnin e të çlironin atdheun.

Asnjë forcë ushtarake fashiste si dhe çdo forcë tjetër civile që bashkëpunonte me fashizmin, nga ajo ditë e në vazhdim, nuk do të lejohej të futej në territoret e Dardhës e të Reçit, qoftë edhe për rrugëtim.

Pas këtyre vendimeve dardhjanet i ftuan dhe i morën për drekë në shtëpitë e tyre të gjithë bash-këlufëtarët reçjanë. Sidomos ata të fshatrave: Tartaj, Lashkizë, Merskanë, Soricë morën kryesisht luftëtarët e Ndërshenës, Gjurrë-Reçit e të Tejmallës, Hurdhë – Reçit, Tharkut. Ndërsa nfa fshatrat e tjera, Dardha, Shënllëshni,etj, morën luftëtarët e Drax - Reçit e te Zall-Reçit. Gjatë orëve të drekës, vetëm për qëndresën në Kodër të Kacës u bisedua dhe tregimet bëheshin me hollësi, ashtu siç u zhilluan në fakt.

Demonstrimet e krahinave të Reç e Dardhës, dësh-mojnë më së miri se këto dy male nga “Nëntë Malet” e Dibrës, kanë qenë, janë e do të mbeten të lidhura ngushtësisht, si dy vëllezër të vërtetë. Që kur janë for-muar për herë të parë si dy krahina e deri në ditët e sotme, Reçi e Dardha janë shquar në veprimtarinë e tyre si bashkëudhetare, bashkë- udhëheqëse, bash-këorganizatore, bashkeluftetare, si dhe bashkëfitim-tare, ndaj edhe kanë një histori të përbashkët.

Filozofia popullore i ka emërtuar ato, si: “rëra dhe gëlqerja” që asnjëra nuk ben pa tjetrën! Midis tyre asnj-herë nuk është shfaqur ndonjë grindje, konflikt apo ndarësi. Ato kanë ditur të bashkëjetojnë në harmoni kurdoherë dhe në çdo situatë, të ruajnë identitetin e vet, shpirtin atdhetar e luftarak që i ka karakterizuar kundër pushtuesve të huaj dhe që i ka bërë këto dy krahina unitare, të cilat janë konsideruar si një “ushtri e rregullt pa uniforme”, me një art të nivelit të lartë. Ndonëse Reç e Dardhë kanë qenë në vështirësi ekono-mike, atyre kurdoherë u ka kënduar pushka kundër armiqve, u ka buzëqeshur mikpritja e bujaria, besa e trimëria për atdheun dhe për mikun.

Në vargun e rrugëtimeve që pati bërë në Shqipërinë e Veriut, Edith Durham, do të kalonte edhe në Lurë të Dibrës, në Mirditë e në disa zona të tjera. “Lura, - thoshte ajo- është bajraku kryesor i grupit të tmerr-shëm të Dibrës, ‘Tigrave’ të Dibrës...”Masiviteti anti-fashist i të dy krahinave ishte një qëndresë e menduar me mençuri, me objektiv të qarta, me një organizim të përsosur. Kjo u shndrrua në një lëvizje antifashiste mbarëpopullore dhe me ndërgjegje të lartë kombëtare. Ajo u bë pikë referimi edhe për krahina të tjera të Di-brës gjatë Luftes Antifashiste Nacionalçlirimtare.

DIBRANËT DEMOSTRUAN QARTAZI SE QENË PËRDERE PATRIOTË

Fashizmi nuk ndërmori më operacione për çarma-tosjen apo ndëshkimin e Reç e Dardhës. Atij nuk i in-teresonte të hapte një vatër lufte të nxehtë përvëluese në ato dy krahina të Dibrës, që përveç forcës njerëzore të pathyeshme, ato i favorizonte edhe terreni strategjik. Në ato gryka të thella, male e maja të larta, shkëmbinj të thepisur e kodra kishin gjetur vdekjen të gjithë ata pushtues që kishin synuar për tu futur në këto treva edhe më parë.

Krahina e Dardhës dhe ajo e Reçit qëndruan të ven-dosura në vendimet që patën marre pas qëndresës në Kodrën e Kacës. Këto treva u bënë të pakalueshme, duke mos lejuar që fashizmi e veglat e tij të fusnin kthetrat e të depërtinin në to.

Kjo u provua në pranverën e vitit 1942, kur fash-izmi do të ndërmerre një operacion në krahinën e Lumës me forca të shumta ushtarake dhe të milicisë civile fashiste. Këto forca sipas planit fashist, do të ka-lonin nëpër territoret e Dardhës e Reçit dhe të futeshin në trevat e Lumës.

Posa u informuan Dardha e Reçi, nën udhëheqjen e drejtimin e prijësave të tyre, sensibilizuan popullin, u organizuan dhe u vendosën në vende kyçe, frontalisht për luftë. U dërguan njoftime krerëve fashistë, si Halil Alisë e të tjerëve, se nëpër territoret e Dardhës e Reçit nuk mund të kaloni.

Forcat ushtarake fashiste dhe milicia që bash-këpunonte me to, u detyruaruan të ndryshonin inten-erarin e lëvizjes. Një ditë më vonë ata do të futeshin në Lumë nga një rrugë tjetër jashtë territoreve të Dardhës e të Reçit.

Dibranët në përgjithësi, demonstruan qartazi, se qenë përdere patriotë, u shfaq lart ndërgjegja kombëtare, se dibranët ishin të gatshëm edhe për beteja të tjera.

DEKRETI

Kryesia e OBVLPUron gjenerallejtënant Kingjin për mandatin e dytë në drejtimin e Shtabit të Përgjithshëm

Gjeneral Lejtnant Arben Kingji merr mandatin e dytë në krye të FA

• Në vlerësim të aftësive dhe vlerave të spikatura si ushtarak me një karrierë të shkëlqyer, të vlerave njerëzore, intelektuale dhe profesionale, Kryesia e OBVLPU shpreh bindjen se gjeneralmajor Kingji është personi i duhur për të drejtuar Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sipas standardeve të NATO-s



Më 11 gusht 2025, në një ceremoni zyrtare, Presidenti Begaj, dekretoi Gjeneral Lejtnant Arben Kingji në detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

ra të Republikës së Shqipërisë për një mandat të dytë.

“Ceremonia nisi me ekzekutimin e Himnit Kombëtar dhe vijoi me leximin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm në mbështetje të Kushtetutës dhe ligjit “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, njoftoi zyra për shtyp të Presidencës.

Pas leximit të dekretit, Gjeneral Lejtnant Arben Kingji bëri betimin me dorën mbi Kushtetutë.

Në ceremoninë e betimit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm mori pjesë Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, Zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm, si dhe komandantët e forcave dhe strukturave të tjera të Forcave të Armatosura.



KUSH ËSHTË ARBEN KINGJI



Gjenerallejtënant Arben Kingji ka lindur në Kukës, më 22 dhjetor 1970. Pas mbarimit të Akademisë Ushtarake “Skënderbej” dhe titullimit officer, ai u emërua komandant toge në Repartin Ushtarak 9001. Në Turqi, kreu Kursin Bazë Komando në vitin 1993 dhe Kursin Bazë të Forcave Speciale në vitin 1999.

Gjenerallejtënant Kingji ka shërbyer në detyra të ndryshme duke përfshirë komandant toge; instruktor taktik; drejtues i Grupit VII Special në Batalionin Komando; shef i S-3 i Batalionit Forcave Speciale; zëvendëskomandant i Batalionit të Forcave Speciale; oficer shtabi për trajnim dhe vlerësim në Komandën e Bashkuar; komandant i Batalionit III në Forcën Tokësore; komandant i Batalionit të Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm; komandant i Batalionit të Policisë Ushtarake; atashë ushtarak në Rumani.

Në shtator 2020, u promovua me gradën madhore gjeneral brigade me dekret të presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe në 02 tetor 2020 u emërua komandant i Forcës Tokësore.

Në 02 gusht të vitit 2022, gjenerallejtënant Kingji mori detyrën e shefit të

Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Në 27 nëntor 2024, me dekret të presidentit të RSH u promovua në gradën më të lartë madhore gjenerallejtënant.

Ai ka shërbyer në katër misione jashtë vendit: tre në Afganistan (2003; 2009; 2012) dhe një në Irak (2006), si komandant kontingjenti në të gjitha misionet.

Gjenerallejtënant Kingji ka kryer përfunduar të gjitha kurset institucionale të oficerit të karrierës, si dhe ka kryer një sërë kualifikimesh të tjera si: Kursin e Standardeve të NATO-s; Kursi i Trajnimit CIMIC; Kursi i Mbrojtjes dhe Sigurisë Personale.

Përgjatë karrierës së tij mbi 39-vjeçare ushtarake është vlerësuar me medalje të ndryshme si: Medalja për Shërbime të Shquara nga ministri i Mbrojtjes; Medalja e Shërbimit; Medaljen e Shërbimit të Merituar dhënë nga SHBA; Medalja NATO-ISAF; Medalja e Shërbimit Ndërkombëtar dhënë nga Ministria e Mbrojtjes; Medalja e Karrierës; Medalje për Shërbime të Veçanta, si dhe Medalja e Artë e Shqiponjës e dhënë nga presidenti i Republikës së Shqipërisë në vitin 2003.

Gjenerallejtënant Kingji flet gjuhën angleze dhe turke. Ai është i martuar me dy fëmijë.

VETERANI

ORGANIZATA E BASHKUAR E
VETERANËVE TË LANÇ DHE PASARDHËSVE

MESAZH URIMI

Drejtuar: Gjenerallejtënant Arben Kingji
Shef i Shtabit të Përgjithshëm të FA të RSH

I nderuar gjenerallejtënant Kingji,

Në emër të Kryesisë së Organizatës të Bashkuar të Veteranëve dhe Pasardhësve të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit Shqiptar (OBVLP), ju shprehim urimet më të mira për dekretimin në detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për një mandat të dytë.

Në vlerësim të aftësive dhe vlerave tuaja të spikatura si ushtarak me një karrierë të shkëlqyer, të vlerave njerëzore, intelektuale dhe profesionale, shprehim bindjen se jeni personi i duhur për të drejtuar Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sipas standardeve të NATO-s.

KRYESIA E OBVLPU

KRYETARI

Tatjana PARLLAKU

Sekretari i Përgjithshëm

Av. Halil RAMA

Mjeshtër i Madh